

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

Nr. / Br. 31856/26

Nr. i fq. / Br. sl. - 1 -

Data: / Datum: 20.07.2026

VUSHTERI - VUČITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 113/26 20/07/2026

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **30 korrik 2026 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 qershor 2026;
2. Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të komunës, për periudhën janar-qershor 2026;
3. Raport gjashtëmuor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026;
4. Pasqyrat financiare për vitin 2025 dhe raporti i auditorit të përgjithshëm;
5. Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit janar-qershor 2026;
6. Raport i veçantë mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarret për periudhën 2023 – qershor 2026;
7. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale
8. Pyetje dhe përgjigje.



Melihate Basholli-Latifi

Kryesuesë e Kuvendit të Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB-34/26 30.07.2026

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË: 25 QERSHOR 2026

Mbledhja është mbajtur në sallën e "Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe filloi në orën 10:20
Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Behar Duraku, Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Fakele Dushi, Fatmire Cecelia, Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Mek Selaci, Melihate Basholli Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Ramadan Parduzi, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Edmond Hyseni, Fidan Bejta, Pllumb Maliqi, Hava Mlinaku, Isak Uka dhe Stefan Markovic.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, - Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 25 anëtarë të kuvendit, kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-pasi konstatoi kuorumin, ceku se materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës janë dorëzuar sipas afateve ligjore, andaj procedoj me rendin e punës sipas rregullores së punës së kuvendit.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- ngriti një shqetësim lidhur me gjendjen e bimëve të cilat janë mbjellë në park e që është katastrofale. Është gjynah prej atyre bimëve me i pa në çfarë gjendje janë mbjellë. Besoni më rrallë i mbjellim patatet në sera ose në kopshte se sa ato pisha që janë aty në parkun e qytetit. Krejt kjo është bërë me qëllim të përmbushjes së kontratës se sa që ka qenë e nevojshme. Prandaj, vlerësoj se kjo është për gjynah se si është duke vepruar komuna.

Gresa Muli, anëtare kuvendit- pasi i përshëndeti të gjithë vijoi: para se të kalojmë në rendin e ditës, kam disa pyetje që pres të marr përgjigje për to. Çështja e parë është, kanë kaluar disa muaj prej një rasti që ka ndodhur që më ka shqetësuar shumë. Jo vetëm mua, por shumë prind e shumë qytetarë të komunës së Vushtrrisë. Është çështja e rastit të ngacmimit seksual që ka ndodhur në një shkollë të Vushtrrisë, që nuk po dua me cek emra për arsye të ndryshme. E di që

komuna e Vushtrrisë, as kryetari i komunës, e as Drejtoria e Arsimit nuk kanë jap të paktën një prononcim për mendimin e tyre rreth kësaj çështje dhe çfarë masa do të ndërmarrin. Pse si Kryetar i Komunës dhe si qeverisje lokale zgjodhët të heshtni përballë një rasti kaq të ndjeshëm? Pse nuk pati një reagim publik, një qëndrim institucional apo një adresim të qartë ndaj këtij shqetësimi kaq të madh. Çështja e dytë ka të bëjë me investimet në fshatin prej nga vij, fshati Sfaraçak. Fshati Sfaraçak ka shumë familje të ardhura nga shumë vende të Vushtrrisë por edhe jashtë Vushtrrisë. Fshati ka shumë ngjyime politike ndoshta për këtë nuk është bërë asnjë investim që nga viti 2017 por edhe më herët në pjesën e Sfaraçakut të Poshtëm përveç rrugës që është ndërtuar dhe dritave që janë bërë me vetëfinancim. Së fundi në mandatin e kaluar në tetor të vitit 2024 është marrë vendim që të bëhet një trotuar rreth 700 metra. Po bëhen gati dy vite prej që kanë ardhur kubëzat, është prishur rruga dhe ende nuk ka përfunduar ajo pjesë. Nxënësit dhe qytetarët kanë probleme kur kalojnë te ajo pjesë. Arsyetimi i Kryetarit ka qenë që nuk ka mjete të mjaftueshme por kohëve të fundit po shoh që po shpenzohet në gjëra jo shumë prioritare e ajo pjesë ka mbetë shumë keq. Ju lutem që të bëni një gjithëpërfshirje edhe nëpër fshatra, sepse seriozisht fshati Sfaraçak ka shumë nevojë për rregullim dhe për investime të tjera. Të them të drejtën, mua si anëtare e Kuvendit dhe përfaqësuese e atij fshati prej tre mandatesh, po më vjen keq edhe t'i takoj fshatarët, sepse ata më thonë se nuk po bëhet asgjë për ta. Prandaj ju kisha lutur shumë që të ndërmerrni masa konkrete në këtë drejtim. Çështja e tretë ka të bëjë me bursat për studentë. Nuk e kam lënë të tretën për nga rëndësia, sepse është shumë e rëndësishme. Pse Komuna e Vushtrrisë ende nuk e ka bërë shpalljen për bursa, ndërkohë që shumica e komunave të tjera tashmë e kanë bërë ndarjen e tyre? Cila është arsyeja e kësaj vonese dhe kur planifikoni të ndani bursat? Dhe në fund lidhur me raportin e auditorit, ku pashë se ka pasur një rast ku transferimi i një mësimdhënësi është bërë pa proces rekrutimi. Dua të di sa raste të tjera të tilla ka dhe a planifikoni t'i shmangni këto shkelje dhe të zbatoni procedura të rregullta në të ardhmen?

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit, deklaroi: kam një shqetësim jo vetëm unë, por e gjithë Vushtrria. Shqetësime ka shumë, por sot dua ta trajtoj këtë çështje në Kuvend, lidhur me situatën e FC Vushtrrisë, ku për shkak të vonesave në pagesa, lojtarët dhe kryesia kanë vendosur një afat deri më 1 korrik. Nëse deri në atë datë nuk ka ndonjë zgjidhje nga kryesia apo nga Komuna, e cila siç kam kuptuar ka pasur disa biseda me lojtarët, atëherë ekziston rreziku që klubi të shuhet plotësisht. Është e pakuptimtë që një klub me traditë dhe histori të pastër të përballlet me rrezikun e shuarjes për shkak të mungesës së stabilitetit financiar. Lojtarët dhe stafi kanë dhënë maksimumin për fanellën e klubit dhe është e drejtë e tyre që obligimet financiare ndaj tyre të përmbushen në kohë. Kjo situatë kërkon angazhim të menjëhershëm nga të gjithë ata që kanë përgjegjësi dhe mundësi për të ndihmuar. Nevojitet dialog, transparencë dhe një plan konkret për tejkalimin e vështirësive financiare, në mënyrë që klubi të vazhdojë garimin dhe të ruaj traditën sportive të qytetit. Ky klub nuk është vetëm një ekip futbollit, por pjesë e identitetit sportiv dhe qytetar të qytetit tonë. Prandaj, duhet të bashkohemi për ta mbështetur dhe për të gjetur zgjidhjen e duhur para se të jetë vonë. Kisha kërkuar edhe nga komuna që, nëse ekziston mundësia të ofroi ndihmë për lojtarët dhe klubin në përgjithësi.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të pranishmit vijoi: shqetësim për ne mbetet udhëkryqi te rruga për fshatin Begaj. Fatkeqësisht kemi pasur raste të tilla dhe më herët por rasti i fundit është te familja Meniqi që e kemi pasur një humbje të jetës të një djaloshi të ri. Shqetësimet tona janë që nuk po e dimë nëse komuna është duke bërë përpjekje që kjo rrugë magjistrale të kalojë në kompetencë të komunës. Deri më tani e dimë që kjo rrugë menaxhohet nga Ministria. Sa kemi qenë pjesë e qeverisjes bashkë me Lëvizjen Vetëvendosje, i kemi bërë disa kërkesa të njëpasnjëshme që kjo rrugë magjistrale të kalojë në kompetencë të komunës, por fatkeqësisht nuk

kemi marrë aprovim për një gjë të tillë. Në bazë të disa informatave që i kemi nga komuna, ministria viteve të fundit ka pasur gatishmëri që një gjë të tillë që kjo rrugë të kalojë në kompetencë të komunës së Vushtrisë, mirëpo nuk kemi pasur vullnet nga komuna, nuk e di nëse kjo qëndron apo jo, mirëpo informatat janë nga komuna. Andaj, ju kisha lutur kryetar, që si qeverisje komunale të ndërmerni diçka dhe dashtë Zoti që në të ardhmen mos të kemi më raste të tilla.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit deklaroi: Dua t'i ngriti dy çështje që mendoj që janë të rëndësishme. E para ka të bëjë me objektin e shkollës fillore "Migjeni" në Stanoc të Epërm tani që është shndërruar në çerdhe. Vitin e kaluar veç është hap çerdhja, ka mbet që Drejtoria e Arsimit të marrë numrin e fëmijëve dhe të procedohet me renovimin e objektit. Fatbardhësisht është bërë një punë e mirë. Pra, çerdhja ka filluar të funksionojë, mirëpo nga ajo që e kemi parë vitin e kaluar është rinovuar vetëm gjysma e objektit dhe gjysma tjetër e objektit ka mbetur pa rinovuar. Në bazë të informatave që kam, aty është rritur numri i fëmijëve. Bëhet fjalë për fshatin Stanoc i Epërm dhe fshatrat përreth, të cilat janë zona ku popullsia vazhdon të jetojë dhe nuk ka pasur lëvizje të konsiderueshme të banorëve. Prandaj është rritur edhe numri i fëmijëve. Kisha një kërkesë për ju kryetar, a e keni në plan që pjesën e mbetur të objektit, e cila për fat të keq është në gjendje jo të mirë, ta renovoni dhe ta zgjeroni për shkak të rritjes së numrit të fëmijëve që ndjekin atë kopsht? Çështja e dytë ka të bëjë me lumin që rrjedh nga Breznica, kalon nëpër Stanoc të Epërm dhe derdhet në lumin Llap. Kanalizimi përgjatë atij segmenti është i dëmtuar. Gjatë verës, kur temperaturat janë të larta, ai kundërmon dhe paraqet rrezik për shëndetin e qytetarëve. Prandaj do të kërkoja që të hartohet një projekt i ri dhe të bëhet sanimi, përkatësisht rregullimi i atij kanalizimi, sepse gjendja vërtet është e keqe.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit- unë kam tri çështje që dua t'i ngre. E para është për dy rrugë në Stanoc të Poshtëm, të cilat janë përgatitur për asfaltim por ende nuk është shtruar asfalti. Aty është krijuar një gjendje e tmerrshme për shkak të pluhurit. E dyta është kanalizimi që vjen nga Stanoci i Epërm. Ai tashmë është bllokuar dhe po del tek lapidari i dëshmorit Nazmi Zhegrova. Është mbushur ajo pjesë dhe fatkeqësisht edhe te shtëpia e Shukri Klunes është bërë problem i madh me kanalizimin. E treta, për drejtorin e Shërbimeve Publike kam një kërkesë edhe pse e di që ajo pronë është e ministrisë, pra ish-Enti i Punësimit. Aty qytetarët kanë ngritur shqetësime për gjendjen e rënduar. Nëse do të kishte mundësi, kërkoj nga drejtori që të angazhohen punëtorët e Ndërmarrjes Publike "Përparimi" për pastrimin e oborrit të atij objekti, sepse gjendja është vërtet e rëndë.

Fakete Dushi, anëtare e kuvendit- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit deklaroi: Kam dy shqetësime. Bëhet fjalë për banorët te varrezat. Është fjala për lagjen "Bekim Zenuni" e cila është në gjendje të rëndë. Në këtë zonë është hap një gropë shumë e madhe, zonë kjo e cila gjatë verës ka frekuentim të madh të njerëzve. Gjithashtu edhe te rruga "Isak Halili", pjesa te varrezat ka mbetur një pjesë e rrugës në zhavor. Është bërë vështirë e kalueshme sidomos kur ka reshje. Dua të ngiti edhe një shqetësim tjetër të banorëve në fshatin Sllatinë, tek ura, në pjesën e sipërme, është dëmtuar rruga dhe është krijuar një gropë shumë e madhe aty. Para dy apo tre javësh, ose rreth një muaji, veç Zoti ka dashtë që të mos bëhet një aksident shumë i rëndë. Qytetarët po kanë vështirësi në qarkullim.

Betim Grabanica, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi: Kam vetëm një shqetësim. Sot, duke ardhur me makinë, hasa në një gropë në rrugë. Kërkoj nga Drejtoria e Inspektoratit që të mbikëqyrë më nga afër punimet e ndërhyrjeve që po i kryen ujësjellësi. E dimë se rrjeti i ujësjellësit është i vjetruar dhe ndërhyrjet janë të domosdoshme. Mirëpo, pas përfundimit të punimeve, rrugët nuk po rikthehen në gjendjen e mëparshme. Mendoj se ky është një shqetësim për të gjithë ne. Duke filluar nga rruga "Bahri Kuçi" e deri në rrugën "Jeton Tërstena", si dhe në

shumë rrugë të tjera, pas ndërhyrjeve nuk po bëhet sanimi i duhur i dëmtimeve. E njëjta situatë po ndodh edhe pranë ekonomive familjare dhe objekteve banesore. Shpesh investohet në asfaltimin e një rruge të re, ndërsa pas vetëm dy ose tre javësh ajo rrugë prishet sërish për shkak të ndërhyrjeve dhe nuk rikthehet në gjendjen e mëparshme. Prandaj, kërkoj nga Drejtoria e Inspektoratit që të jetë më vigjilente në këtë aspekt dhe të sigurojë që, pas çdo ndërhyrjeje, rrugët të sanohen dhe të rikthehen në gjendjen e tyre fillestare.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- pasi i përshëndeti të pranishmit, deklaroi: po filloj me pyetjen e parë që e ngriti anëtari i kuvendit z. Refik Maloku, lidhur me bimët e mbjella në parkun e qytetit. Dua t'ju njoftoj se kemi hapur dy puse në parkun e qytetit. Fatkeqësisht, pusi i parë nuk ka pas ujë. Ndërsa pusi i dytë, pas gërmimit në një thellësi mbi 100 metra, ka siguruar ujë. Aktualisht është duke u instaluar sistemi i ujitjes, njësoj siç është instaluar edhe në rrethërrrotullime, në mënyrë që të mos ketë probleme me mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra. Sa i përket mbjelljes së shpeshtë të disa bimëve, ato janë mbjellë përreth teqesë sepse hapësira përreth parkut do të shfrytëzohet edhe për lojërat e fëmijëve dhe besoj se, pas përfundimit të të gjitha punimeve, do të kemi një park shumë funksional dhe të bukur. Ka mbetur edhe një pjesë e murit që duhet të rregullohet për të zbutur pamjen e betonit në atë zonë. Pajtohem se disa bimë janë tharë. Megjithatë, kompania kontraktuese e ka ende përgjegjësinë për mirëmbajtjen dhe ujitjen e tyre. Në rast se ndonjëra prej tyre thahet, ajo do të zëvendësohet me të re. Natyrisht, është e dhimbshme të shohësh që edhe një bimë të thahet. Sa i përket shqetësimeve që i ngriti znj. Gresa Muli, ne kemi reaguar menjëherë. Ndoshta e keni parë edhe në rrjetet sociale. Megjithatë, nuk kam preferuar të bëj shumë publikime, sepse mendoj se gjuha e komunikimit në rrjetet sociale është degraduar ndjeshëm. Është krijuar një klimë e acaruar dhe besoj se të gjithë duhet të kontribuojmë për ta përmirësuar atë, jo vetëm ne që jemi këtu, por e gjithë shoqëria. Fatkeqësisht, po përdoret një gjuhë shumë fyese dhe helmuese. Për çdo rast që paraqitet ka komente nga njerëz që e njohin fushën, por edhe nga të tjerë që nuk kanë njohuri, megjithatë ofendojnë dhe gjykojnë pa bazë. Ne kemi qenë vazhdimisht në kontakt me organet e rendit. Epilogu i rastit tashmë dihet, ashtu si edhe vendimi që ka marrë Komuna e Vushtrrisë, në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat që ka. Personi është larguar nga puna, është arrestuar dhe tashmë rasti ndodhet në duart e organeve të drejtësisë. Megjithatë, më duket se mediat dhe rrjetet sociale po e rëndojnë edhe më shumë gjendjen duke e ngarkuar opinionin publik me përmbajtje negative. Besoj se kemi obligim që qytetarëve t'u ofrojmë edhe lajme pozitive, të promovojmë shembuj të mirë dhe të kontribuojmë në krijimin e një klime më të shëndetshme në shoqëri. Sa i përket investimeve në fshatin Sfaraçak, nuk mund të them se nuk është investuar fare, por as se janë përmbushur të gjitha nevojat. Ka pasur investime, megjithatë pranoj se i kemi mbetur borxh këtij fshati. Sfaraçaku është një ndër fshatrat me shtrirjen më të madhe territoriale dhe me vendbanime të shpërndara. Kemi investuar në rrjetin e kanalizimit, i cili më parë nuk ka ekzistuar fare, kemi zgjeruar rrjetin e ujësjellësit dhe kemi investuar edhe në ndriçimin publik gjatë mandatit tim. Megjithatë, pranoj se kemi mbetur borxh për ndërtimin e trotuarit. Një ndër arsyt kryesore ka qenë mungesa e mjeteve financiare, e shkaktuar edhe nga detyrimet që kanë rrjedhur nga kontrata kolektive. Kjo situatë ka ndikuar dukshëm në realizimin e projekteve, deri në atë masë sa u kemi mbetur borxh edhe operatorëve ekonomikë, të cilët për këtë arsye nuk kanë mundur t'i përfundojnë punimet sipas planifikimit. Sa u përket bursave për studentë, edhe kjo çështje lidhet me mungesën e mjeteve buxhetore. E dimë afatin kur është dashur të realizohen, mirëpo për shkak të kufizimeve financiare nuk kemi pasur mundësi t'i ndajmë mjetet e planifikuara. Sa i përket raportit të auditorit, ju ftoj ta lexoni me kujdes. Përveç çështjes së pagesave nga kode të ndryshme buxhetore, e cila ka ndikuar që raporti të jetë i kualifikuar, nuk ka gjetje të theksuara. Nëse do të kishte parregullsi të tjera me rëndësi, ato do të ishin evidentuar në

raport. Për rastin konkret që është përmendur, po ju them sinqerisht se nuk kam qenë në dijeni, por do të merrem personalisht me të. Shqetësimi që ngrite anëtari i kuvendit z. Ramadan Parduzy është plotësisht me vend. Ai është shqetësim i yti, i të gjithë anëtarëve të Kuvendit edhe i imi. Sa i përket klubit të futbollit, nuk jemi ndalur së investuari. Aktualisht është duke u rregulluar stadiumi në Dobërlukë, me qëllim që të shërbejë si stadium ndihmës për zhvillimin e stërvitjeve dhe ndeshjeve. Atje janë realizuar punime të konsiderueshme. Sa u përket pagave të lojtarëve, përgjegjësia u takon kryesisht së klubit dhe sponsorëve. Nga ana e komunës kemi vepruar në kuadër të kompetencave ligjore. Pas inkuadrimit të klubit në Super Ligë, kam marrë vendim që secili lojtar të mbështetet financiarisht nga komuna. Menjëherë kam nxjerrë vendimet dhe secili lojtar ka përfituar nga 1.000 euro. Po dua të jem plotësisht transparent me ju. Nuk e kam marrë këtë vendim para ndeshjes, edhe pse e dija se lojtarëve u ishin vonuar pagat. Nuk kam dashur që para ndeshjes t'u them: "Dilni dhe fitoni, sepse do të merrni këtë mbështetje financiare." Kam preferuar që vendimin ta zbatoj pasi e përfunduan me sukses garën. Më pas i kam thirrur dhe ua kam shpjeguar arsyet pse nuk e kam bërë më herët. Sikur t'i kishin marrë të gjitha pagat me kohë, do të kishim vepruar ndryshe. Sa i përket informatës së z. Berat Sadiku që ngrite, ajo nuk është e saktë. Segmenti rrugor nga vendi ku ndahet autostrada, tek Nadakovci, përgjatë Vushtrrisë deri në Smrekonicë, është pronë e ministrisë dhe menaxhohet nga ajo ministri. Komuna ka dërguar dy kërkesa zyrtare me shkrim që ky segment t'i bartet në menaxhim. Më herët kjo ka qenë më e vështirë, pasi nuk ka pasur rrugë alternative. Tani, me përfundimin e autostradës deri në Smrekonicë, ekziston mundësia që kjo përgjegjësi t'i kalojë komunës. Në emër të Komunës së Vushtrrisë shpreh edhe një herë ngushëllimet më të sinqerta për familjen e viktimës. Edhe unë personalisht jam prekur shumë nga ai rast tragjik dhe besoj se secili prej nesh e ka përjetuar rëndë. Fatkeqësisht, nuk ka qenë rasti i vetëm në atë segment rrugor. Po e them publikisht: në momentin që ministria na e bart këtë rrugë në pronësi dhe menaxhim, do të ndërtojmë rrethrotullime në ato udhëkryqe. Besoj se kjo është zgjidhja më e mirë dhe më e sigurt, shumë më efektive sesa semaforët, të cilët shpeshherë nuk funksionojnë si duhet. Nëse është e nevojshme, kërkesat zyrtare që kemi dërguar mund t'i publikojmë edhe në faqen zyrtare të komunës, në mënyrë që çdo qytetar të bindet se Komuna e Vushtrrisë ka ndërmarrë të gjitha veprimet që i takojnë. Nuk kam dëshirë të merrem me akuza dhe kundër akuza. Problemet nuk zgjidhen me deklaratat, por me punë konkrete. Prandaj, do të kërkoj edhe një takim të drejtpërdrejtë me ministrin, për t'ia paraqitur edhe njëherë këtë kërkesë. Nëse rruga na bartet në menaxhim, komuna do ta marrë përgjegjësinë e plotë për investimet dhe mirëmbajtjen e saj. z. Ymer Haradinaj, të falënderoj për kontributin tënd në lidhje me atë objekt. Ke qenë shumë këmbëngulës që në mandatin para këtij, jo në mandatin tim, që ai objekt të kthehet në çerdhe, pra t'u kthehej nxënësve. E ke pasur mbështetjen tonë dhe, objekti tashmë u është kthyer nxënësve. Sa i përket renovimit të tij, në atë kohë kemi pasur mjete dhe mundësi vetëm për të ndërhyrë pjesërisht, me qëllim që t'u përgjigjeshim kërkesave të qytetarëve dhe të fillonim punimet në përputhje me mundësitë që kishim. Megjithatë, mbetet ende shumë punë për t'u bërë, pasi objekti duhet të rinovohet tërësisht. Me planifikimin e buxhetit për vitin 2027 do ta analizojmë këtë projekt dhe do ta përfshijmë në buxhet, në mënyrë që renovimi të përfundojë plotësisht. Sa i përket kanalizimit, përkatësisht kolektorit kryesor, projekti tashmë është hartuar. Është e vërtetë se ai kalon nëpër shtratin e lumit dhe jemi të vetëdijshëm për problemet që janë krijuar. Kam qenë personalisht disa herë në terren dhe kam vizituar familjet që preken drejtpërdrejt nga kjo çështje. Ju siguroj se edhe ky problem do të zgjidhet. Kjo përfshin edhe Stanocin e Ulët dhe zonat e tjera që preken nga ky kolektor. Sa i përket rrugëve që i përmendët, ato janë përgatitur për asfaltim. Bëhet fjalë për rrugën prej Lumit të Madh deri në Stanoc të Ulët, si dhe për rrugën në Lagjen e Muhaxherëve. Në këtë të fundit kemi bërë zgjerimin e rrugës nga 3

metra në 5 metra, pasi ishte shumë e ngushtë dhe i shërben një numri të madh banorësh. Megjithatë, problemi vazhdon të jetë tek operatorët ekonomikë. Dje kam komunikuar me menaxherin e projektit dhe më është konfirmuar se punimet për asfaltim do të fillojnë javën e ardhshme. Edhe operatorët janë përballur me vështirësi për shkak të rritjes së çmimit të naftës dhe mungesës së mjeteve financiare, pasi komuna u ka mbetur borxh për një pjesë të punëve të kryera. U kam kërkuar që punimet t'i përfundojnë, ndërsa obligimet financiare do t'i shlyejmë gjatë vitit të ardhshëm, sepse nuk mund të planifikojmë shpenzime përtej mundësive buxhetore dhe duhet të kemi parasysh edhe borxhet ekzistuese. Sa i përket rrugëve "Bekim Berisha" dhe "Isak Halili", projekti për rrugën "Isak Halili" është hartuar dhe ajo do të ndërtohet sipas të njëjtit standard si rruga "Lumni Surdulli". Pjesa që është përmendur nuk është përfunduar ende, prandaj edhe është në atë gjendje. Rruga "Isak Halili" do të realizohet me të njëjtin standard si rruga "Lumni Surdulli", ashtu siç është planifikuar. Ndërsa për rrugën në Sllatinë, keni plotësisht të drejtë. E di saktësisht për cilin vend bëhet fjalë. Aty kanë intervenuar ekipet e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit. Komuna është munduar t'i dalë në mbështetje kësaj kompanie, në mënyrë që qytetarët të marrin shërbimet e nevojshme, pasi kompania nuk ka kapacitete t'i rikthejë rrugët në gjendjen e mëparshme. Për këtë arsye kemi marrë përsipër që, pasi të përfundojnë punimet, asfaltimin ta kryejë komuna. Megjithatë, gropa është dashur të mbyllet dhe të mos lihet në atë gjendje. I kërkoj drejtorit që të dalë urgjentisht në terren, sepse edhe dje mora një ankesë nga një qytetar për këtë problem. Sa i përket vendosjes së pengesave në rrugë, ka shumë kërkesa nga qytetarët. Megjithatë, duhet të ndryshojmë rregulloren dhe ta rikthejmë atë në Kuvend, pasi çmimi aktual është shumë i ulët. Nuk mund të kërkohet që operatorët ekonomikë të ndërhyjnë për prerje dhe asfaltim të sipërfaqeve shumë të vogla me të njëjtin çmim që aplikohet për shtrimin e asfaltit. Asnjë operator nuk pranon të kryejë punime për vetëm disa metra katrorë me çmimet aktuale. Kjo çështje duhet të rregullohet. Sa i përket rrugës "Bahri Kuqi", projekti është hartuar, pasi ajo lidhet me autostradën. Është paraparë që të ndërtohet sipas standardeve, me infrastrukturë nëntokësore, kabllim tokësor dhe ndriçim publik deri në qendër të fshatit Gojbul. Kështu është parashikuar në projekt.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- tha se, po ndërlidhem me deklarin e kryetarit në lidhje me fshatin Sfaraçak, ku u tha se të gjitha punët në sistemin e ujësjellësit janë kryer gjatë këtij mandati. Dua të sqaroj se kjo nuk qëndron. Më kujtohet shumë mirë se Sfaraçaku ka qenë i inkorporuar në sistemin e ujësjellësit që para luftës. Pas luftës, gjatë mandatit tonë, është zgjeruar rrjeti edhe në një grup të ri të banorëve dhe është bërë lidhja e shumë lagjeve që deri atëherë nuk kanë qenë të kyçura në sistem. Sa i përket punëve që janë kryer në këtë mandat, aq sa kam njohuri, është bërë vetëm vendosja e një pompe, përkatësisht një ndërhyrje për rritjen e shtypjes së ujit. Të gjitha punët e tjera, përfshirë rrjetin dhe kyçjet individuale, janë realizuar më herët, gjatë mandatit tonë. Prandaj, nuk mund të thuhet se të gjitha punët në sistemin e ujësjellësit në fshatin Sfaraçak janë kryer në këtë mandat.

Benjamin Shala, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi: po ndërlidhem fillimisht me çështjen që e ngriti znj. Gresa, lidhur me trotuarin që ka mbetur i papërfunduar tash e dy vjet. Punimet kishin filluar sipas projektit, mirëpo në momentin kur përmbaruesi ka tërhequr mjetet financiare nga kodi buxhetor i këtij projekti, ato janë ndërprerë. Furnizimi ishte realizuar dhe materialet kishin mbërritur në vend punishte, por punimet nuk kanë mundur të vazhdojnë. Prandaj, do t'ju lutesha të gjithëve, si grupe parlamentare dhe si anëtarë të Kuvendit, që ta mbështesni komunën tek Ministria e Financave, në mënyrë që të na kthehen mjetet për investime kapitale. Nuk po kërkoj që të na kthehen të gjitha mjetet, por vetëm ato që u janë marrë projekteve të papërfunduara. Nëse këto mjete rikthehen, projektet do të përfundojnë dhe nuk

do të ketë asnjë pengesë tjetër. Sa i përket sistemit të ujësjellësit, dua të theksoj se, kur ju e morët përgjegjësinë për qeverisjen, në pjesët më të larta të fshatit Sfaraçak nuk kishte ujë. Përrjashtim bënë vetëm ato zona që kishin furnizim me ujë që para luftës. Në asnjë pjesë tjetër nuk kishte furnizim të rregullt. Sot situata është ndryshe. Edhe pikat më të larta të fshatit Sfaraçak kanë furnizim me ujë.

Melihate Basholli- Latifi, kryesuese e kuvendit- me kaq po e përmbysim pjesën e parë. Kalojmë tek pjesa e diskutimeve për rendin e ditës.

Benjamin Shala, Drejtor i Shërbimeve Publike- pas konsultimit javën e fundit me disa biznese, rreth kategorizimit të bizneseve, kemi parë që ka hapësira me diskutuar edhe këtë seancë e tërheqim nga diktimi Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 20 vota “për”, 1 votë “kundër”, aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 maj 2026;
2. Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2027-2029;
3. Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje për vitin 2025;
4. Propozim – vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 294/19, të datës 31.10.2019 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.
5. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 maj 2026;

Pas shqyrtimit, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës së Vushtrrisë, mbajtur në datën 28 maj 2026.

2. Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2027-2029;

Melihate Basholli- Latifi, kryesuese e kuvendit- tha se Draft - Korniza Afatmesme për vitet 2027-2029 është diskutuar edhe në Komitetin për Politikë e Financa. Përveç kësaj e kemi dhe kalendarin për dëgjimet buxhetore. Anëtarët e KPF-së veç i kemi caktuar në vendet ku do të jemi, ndërsa ju anëtarë të tjerë të Kuvendit ju ftoj që posa ta merrni kalendarin të merrni pjesë në dëgjime buxhetore.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit vijoi: Korniza Afatmesme buxhetore 2027-2029 është dokumenti bazë për planifikimin e buxhetit komunal i cili përmban prioritete strategjike lidhur me çatët e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve mbi bazën e të cilët planifikohet buxheti për vitin 2027 si dhe projeksioni për dy vitet e ardhshme 2028-2029. Nga dokumenti shihet se komunat pranojnë grante operative nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe ato janë: granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim dhe granti specifik për shëndetësi. Në vitin 2026 granti i përgjithshëm për komunën e Vushtrrisë është 12,210,626 euro kurse për vitin 2027 falë qeverisë Kurti ky grant rritet dhe arrin vlerën 13,366,922€. Tek granti specifik për arsim kemi rënie sigurisht për shkak të zvogëlimit

të numrit të nxënësve. Pra nga viti 2026 në vitin 2027 kemi një rënie të lehtë. Kurse granti për shëndetësi në vitin 2026 e ka vlerën 3,062,052€ kurse për vitin 2027 edhe ky grant ka rritje të vlerës në 3,231,203€. Në tërësi vlera e granteve në komunën tonë në vitin 2027 është 27,731,331 € kurse buxheti i përgjithshëm për vitin 2026 ka qenë afër 30 milion, ndërsa për vitin 2027 ky buxhet do të ketë rritje dhe ka vlerën 31,683,408 €. Korniza Afatmesme Buxhetore është një dokument financiar që duhet të paraqesë vizionin e komunës, menaxhimin e përgjithshëm të financave publike dhe ofrim të shërbimeve cilësore që në rastin e komunës sonë po mungon. Përmes këtij dokumenti do të duhej të krijohej një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet kërkesave të qytetarëve, prioriteteve strategjike komunale dhe mundësive reale financiare, duke siguruar që çdo euro e buxhetit komunal të shfrytëzohet në mënyrë sa më efikase dhe me ndikim sa më të madh në jetën e qytetarëve që në rastin e komunës sonë nuk po ndodh. Nga ajo që po shihet dhe po dëgjojmë edhe sot nga paraqitjet publike të kryetarit të komunës sonë, komuna e Vushtrrisë nuk ka buxhet të qëndrueshëm financiar, nuk ka bërë planifikim realist dhe nuk ka orientuar investimet publike drejt sektorëve me ndikim më të madh në zhvillimin ekonomik dhe social të komunës sonë. Korniza Afatmesme Buxhetore dhe takimet buxhetore me qytetarë do të duhej të mundësonin përfshirjen aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, harmonizimin e projekteve me kapacitetet financiare, dhe të siguroj që projektet të jenë të mbështetura në burime reale financiare. Do të duhej të ketë tregues që dëshmojnë për nevojën e vazhdueshme të investimeve në infrastrukturë, në arsim, në shëndetësi, mjedis dhe në zhvillim ekonomik lokal. Sa i përket arsimit për vitin 2027, kërkojmë nga komuna që të kemi arsim më cilësor, përmirësim të infrastrukturës shkollore, investime në pajisje dhe teknologji dhe krijimit të kushteve më të mira për nxënës dhe mësime mësimdhënës. Sa i përket shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, kërkojmë të bëhet modernizimi i objekteve shëndetësore, përmirësimi i shërbimeve për qytetarët dhe mbështetja e kategorive sociale në nevojë. Kurse tek infrastruktura dhe mjedisi kërkojmë të bëhet ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve, zgjerimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe projekte të cilat ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të pranishmit, vijoi: u bë një kohë e gjatë që po vërejmë se dëgjimet buxhetore po karakterizohen nga pjesëmarrje e ulët, madje në disa raste po shkojnë drejt dështimit. Mendoj se kjo është një çështje shqetësuese, e cila vjen si pasojë e një arsyeje të caktuar, e ajo është mos përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Kjo nuk është një dukuri që lidhet vetëm me qeverisjen aktuale, por ka qenë e pranishme tash e 26 vjet. Dua të ndaj një praktikë që e kemi zbatuar gjatë periudhës 2017–2021, lidhur me orientimin e kategorive, përkatësisht shtyllave buxhetore të komunës. Atëherë kemi realizuar një anketë online për qytetarët dhe rekomandoj që një praktikë e tillë të zbatohet edhe tani. Jemi në vitin 2026, teknologjia po avancohet vazhdimisht dhe jeta është bërë më dinamike. Ndoshta qytetarët, përveç se nuk po ndihen të përfshirë në procesin e vendimmarrjes dhe në adresimin e kërkesave të lagjeve apo fshatrave të tyre, do ta kishin më të lehtë të japin propozimet përmes një ankete online, duke shprehur mendimin se në cilat fusha duhet të orientohet buxheti komunal për vitin 2027, qoftë në ekonomi, shëndetësi, arsim, kulturë, shërbime publike apo në sektorë të tjerë. Pse të mos krijohet edhe një mundësi shtesë, ku qytetarët të kenë rastin të paraqesin nevojat dhe kërkesat e tyre lokale, që kanë të bëjnë me lagjet, fshatrat apo rrugët e qytetit tonë? Për mua, si ekonomist, aspekti socio-ekonomik mbetet veçanërisht shqetësues. Mendoj se do të ishte e nevojshme që së bashku të themelonim një ekip pune ose një komision, me mandat për tre vitet e ardhshme, i cili do të analizonte në vazhdimësi të gjitha çështjet dhe ankesat që ndërlidhen me gjendjen socio-ekonomike të qytetarëve. Ju e dini se, përveç detyrës sime si anëtar i Kuvendit Komunal, ushtroj

edhe një përgjegjësi tjetër, ku çdo ditë ballafaqohem me gjendjen socio-ekonomike të qytetarëve. Fatkeqësisht, rajoni ynë renditet ndër pesë komunat me gjendjen më të rëndë ekonomike dhe me numrin më të madh të përfituesve të asistencës sociale. Ky komision do të mund të trajtonte, muaj pas muaji, të gjitha ankesat dhe nevojat e evidentuara, duke analizuar se çfarë mund të mbështetet realisht nga buxheti komunal, me qëllim që familjeve në nevojë t'u sigurohen së paku shërbimet bazike dhe të lehtësohet gjendja e tyre ekonomike. Këto ishin dy propozimet e mia. Së pari, procesi i dëgjimeve buxhetore të shoqërohet edhe me një anketë online, e cila mund të realizohet lehtësisht në bashkëpunim me Zyrën e IT-së. Së dyti, aspekti socio-ekonomik të ketë një vend më të rëndësishëm në planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2027.

Isuf Jashari-Drejtor për Buxhet dhe Financa- pasi përshëndeti të pranishmit, në adresimin e tij para kuvendit vijoi: sikurse çdo vit, edhe këtë vit, në bazë të Qarkores Buxhetore Nr. 01/2027, jemi të obliguar të hartojmë dhe propozojmë Dokumentin Strategjik, i cili shërben si bazë për planifikimin e buxhetit për periudhën 2027–2029. Në kuadër të këtij dokumenti kemi përgatitur një analizë të detajuar, e cila është në dispozicion të komunës dhe përfshin planifikimin e të hyrave dhe të shpenzimeve si dhe projeksionet për dy vitet pasuese, përkatësisht 2027-2029. Bazuar në kërkesat që kemi pranuar, është e pamundur që të gjitha të përfshihen brenda kufijve buxhetorë në dispozicion. Për këtë arsye, kemi bërë një planifikim të përgjithshëm të programit buxhetor, duke u mbështetur në kategoritë ekonomike dhe në kufijtë e grantit të përcaktuar me Qarkoren Buxhetore nr. 01/2027. Pas këtij hapi do të publikohet edhe Qarkorja Buxhetore nr. 02, me të cilën do të specifikohen kategoritë ekonomike, përkatësisht pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet, si dhe investimet kapitale. Qëllimi ynë është që buxheti të shpërndahet në mënyrë të drejtë ndërmjet këtyre kategorive ekonomike dhe, në këtë mënyrë, të harmonizohen sa më mirë kërkesat e paraqitura me mundësitë buxhetore. Prioriteti ynë fillestar do të jetë shlyerja e obligimeve të papaguara. Më pas, mjetet e mbetura do të orientohen drejt projekteve më emergjente dhe atyre që kanë ndikimin më të madh për qytetarët. Kjo do të realizohet në bashkëpunim dhe konsultim me Kuvendin Komunal dhe ekzekutivin, me qëllim të hartimit të një plani buxhetor sa më të balancuar dhe funksional.

Në fund të debatit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 16 vota “për”, 6 vota “kundër”, vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2027/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2027-2029.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029 e Komunës së Vushtrrisë.
3. Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje për vitin 2025;

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- fillimisht, dëshiroj t'ju njoftoj se edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa kam kërkuar material shtesë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, pasi materiali i ofruar është tepër i mangët dhe informacioni nuk është i detajuar. Tema e trajtuar në këtë pikë lidhet me procedurën e legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje për vitin 2025. Në këtë drejtim, kam disa paqartësi dhe vërejtje. Së pari, nëse flasim për legalizimin e objekteve të

ndërtuara në vitin 2025, atëherë shtrohet pyetja se cila është arsyeja që qytetarët të aplikojnë për leje ndërtimi, kur ekziston perceptimi se çdo vit po realizohet procesi i legalizimit. Për këtë arsye, konsideroj se edhe vetë titulli i materialit është i pasaktë dhe i paqartë. Sa i përket statistikave të Drejtorisë së Urbanizmit, aty paraqiten kërkesa të aprovuara, në shqyrtim dhe të refuzuara, për kategori të ndryshme. Megjithatë, kam kërkuar që të na ofrohet një informacion më i detajuar. Drejtor, edhe pse nuk keni qenë i pranishëm në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, besoj se përmes sekretarisë së kuvendit, jeni njoftuar me shkrim lidhur me kërkesën time për sqarim shtesë: cilat janë objektet e kategorisë së parë dhe të dytë që parashihet të legalizohen, si dhe cili është afati kohor i procesit të legalizimit, përkatësisht deri në cilin vit përfshihen objektet. Në këtë material po krijohet përshtypja se po përfshihen edhe objektet e ndërtuara në vitin 2025, gjë që nëse është e saktë, atëherë bie logjika e aplikimit për leje ndërtimi, pasi qytetarët do të konsideronin se ndërtimi pa leje legalizohen automatikisht në të ardhmen. Prandaj, kam kërkuar që informacioni të detajohet dhe të qartësohet, sepse aktualisht është i paqartë dhe i mangët. Gjithashtu, konsideroj se materiale të tilla duhet të jenë të përgatitura në formë të shkruar dhe të dorëzuara me kohë, pasi ne kemi dy mbledhje në muaj dhe duhet të kemi informacion të plotë për të marrë vendime të duhura.

Drilon Jusufi- drejtor i DUMM-së- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi: Sa i përket çështjes së legalizimeve për vitin 2025, sqaroi se bëhet fjalë për kërkesat e trajtuara gjatë këtij viti. Legalizimi i objekteve pa leje mund të bëhet vetëm për objektet të cilat, sipas ortofotos, rezultojnë të jenë ndërtuar deri në vitin 2018. Pra, përfshihen objektet që shihen në ortofoton e vitit 2018 dhe më herët, përkatësisht objektet e ndërtuara që nga periudha pasluftës e deri në atë vit. Pyetja ka qenë se cilat objekte janë trajtuar gjatë vitit 2025. Në këtë periudhë kemi pasur gjithsej 98 kërkesa për legalizim. Prej tyre, 8 kërkesa kanë qenë të kategorisë së dytë. Kategoria e dytë përfshin objektet mbi 450 m², si dhe disa kriteret e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Ndërsa kategoria e parë përfshin objektet banimore dhe afariste, përkatësisht të gjitha objektet që janë nën 450 m². Sa i përket pyetjes se cilat objekte janë pa leje ndërtimi, duhet theksuar se nuk ka një evidencë të plotë të të gjitha objekteve pa leje, pasi që nga periudha e pasluftës janë ndërtuar shumë objekte në të gjithë territorin e Kosovës, të cilat ende nuk janë evidentuar në mënyrë të plotë. Lidhur me pyetjen se cilat objekte do të legalizohen, aktualisht nuk mund të jepet një listë e saktë, pasi procesi varet nga përmbushja e kriterëve ligjore nga aplikuesit. Gjithashtu, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e ka zgjatur afatin për aplikim për legalizim deri në fund të vitit 2026. Fillimisht afati ka qenë deri në fund të dhjetorit 2025, por është shtyrë me vendim të ministrisë dhe aktualisht është i vlefshëm deri në fund të vitit 2026. Nuk dihet ende nëse ky afat do të vazhdohet më tej. Sa i përket klasifikimit të objekteve, nga 98 kërkesat e pranuar gjatë vitit 2025, 90 janë të kategorisë së parë, ndërsa 8 janë të kategorisë së dytë. Të aprovuara prej tyre janë 50. Ndërsa në listë pritjeje janë 30, pasi nuk i kanë plotësuar kriteret e nevojshme, disa prej të cilave kanë dalë jashtë vijës ndërtimore dhe nuk përmbushin kushtet për legalizim. Dy kërkesa janë refuzuar, dy janë të përsëritura, ndërsa 14 kërkesa janë ende në proces të shqyrtimit.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit- tha se Vushtrria është një vend mjaft specifik në Kosovë. Të gjithë krenohemi me historinë e Vushtrrisë. Mendoj se kemi disa arkitektë dhe profesionistë të fushës, të cilët duhet të japin një kontribut më të madh, veçanërisht gjenerata e re dhe ata që janë të angazhuar në proceset vendimmarrëse. Si ekonomist, nuk e kam plotësisht të qartë çështjen e afatit të zgjatur për legalizim deri në fund të vitit 2026. A nënkupton kjo që të gjitha ndërtimet e realizuara deri në këtë periudhë do të legalizohen automatikisht? Kjo është pyetja ime. Gjithashtu, nëse ka vendime që janë refuzuar, do të ishte e rëndësishme të sqarohen arsyet e refuzimit, në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë të procesit. Mendoj se është shumë e rëndësishme dhe e dobishme që të kemi një informatë të përgjithshme dhe të saktë për numrin e përafërt të objekteve apo ndërtimeve pa leje që ekzistojnë në komunën tonë. Natyrisht, informacioni nga inspektorati është i domosdoshëm, por do të ishte e nevojshme një bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet drejtorisë së

Urbanizmit dhe Drejtorisë së Inspektimeve, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të plotë dhe të saktë të gjendjes në terren, përfshirë të gjitha të dhënat dhe format e evidentimit që disponohen. **Drilon Jusufi- drejtor i DUMM-së-** siç u tha edhe nga Kryesuesja e Kuvendit, objektet të cilat janë ndërtuar deri në vitin 2018 mund të legalizohen, por vetëm nëse i plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore. Ndër kriteret kryesore është që objekti të jetë brenda parcelës përkatëse, si dhe të përmbushë edhe kriteret e tjera të parapara me legjislacionin në fuqi. Kushti kryesor është që objekti të mos e tejkalojë parcelën ndërtimore. Natyrisht, ekzistojnë edhe kritere të tjera të cilat duhet të plotësohen në procesin e legalizimit. Ky vendim është i Ministrisë përkatëse dhe vlen për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, jo vetëm për një komunë të caktuar. Është një vendim që është miratuar më herët dhe ka qenë në fuqi edhe në periudhat paraprake.

4. Propozim – vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 294/19, të datës 31.10.2019 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- konsideroj se është e rëndësishme që në rastet e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, siç ishte rasti i fundit me spitalin, të vendosen afate të qarta dhe të përcaktuara kohore. Në përgjithësi, është praktikë e mirë që toka komunale, kur jepet për investime të ndryshme, të shoqërohet me afate të përcaktuara, në mënyrë që në rast se projekti i paraparë nuk realizohet, prona t’i kthehet sërish komunës. Në këtë drejtim, si Lëvizje Vetëvendosje, e përkrahim këtë vendim.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- tha se ka deklaruar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, siç e tha edhe shefi i grupit se ne e kemi përkrahur këtë vendim. Megjithatë, dëshiroj të shtoj edhe disa sqarime shtesë. Në mandatin e kaluar kemi qenë pjesë e një komisioni që ka punuar në verifikimin e dhënies së pronave komunale në një periudhë të caktuar. Në atë kohë, projekti në fjalë ka qenë i planifikuar për t’u realizuar në vitet 2019–2021, por nuk është realizuar për shkak të paraqitjes së pandemisë COVID-19, pastaj edhe luftës mes Rusisë dhe Ukrainës. Si anëtar i atij komisioni, së bashku me Agron Përçuku, Bekim Zabërgja, Zojë Hajrizi, si dhe përfaqësuesit e kompanisë investuese, kemi zhvilluar takime dhe diskutime lidhur me këtë projekt. Në ato takime, përfaqësuesit e kompanisë e kanë pranuar se projekti nuk do të realizohej dhe është arritur dakordim për tërheqjen nga investimi. Më pas, kjo është raportuar edhe në Kuvend, përmes procesverbaleve dhe dokumenteve zyrtare, ku është evidentuar se palët kanë pranuar ndërprerjen e projektit dhe janë tërhequr nga marrëveshja. Në këtë mënyrë është arritur një marrëveshje e ndërsjellë dhe me mirëkuptim, ku është shmangur mundësia e padive reciproke, si nga ana e kompanisë ndaj komunës, ashtu edhe nga ana e komunës ndaj kompanisë, duke marrë parasysh që të dyja palët kishin mosrealizim të disa obligimeve kontraktuale. Prandaj, konsideroj se ky është një rast i zgjidhur me mirëkuptim, dhe prona e mbetur përbën një vlerë të shtuar për komunën tonë.

Në fund të debatit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 23 vota “për”, 1 votë “kundër”, vendosi me sa vijon:

1. Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë nr. 294/19, datë 31.10.2019, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale – parcela kadastrale P-70202022-00512-1, ZK-Gracë, në sipërfaqe prej 53693 m².

2. Shfuqizimi i Vendimit të cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet duke u bazuar në mosrealizimin e kontratës:

2.1. Investimi i paraparë nuk është realizuar;

2.2. Prona komunale nuk është vënë në funksion sipas destinimit të miratuar;

2.3. Nuk janë përmbushur obligimet esenciale të përcaktuara me kontratë;

2.4. Nuk është realizuar interesi publik dhe ekonomik për të cilin është dhënë prona komunale në shfrytëzim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

4. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi-shfuqizohet çdo akt që ka derivuar nga ky Vendim.

5. Pyetje dhe përgjigje.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- pyetja ime i drejtohet Drejtorit të Financave, i cili nuk është i pranishëm në këtë pjesë të mbledhjes, dhe ka të bëjë me disa paqartësi në projekt buxhetin për vitin 2027. Së pari, dëshiroj të pyes pse në projekt buxhetin për vitin 2027 janë planifikuar më pak të hyra vetanake krahasuar me vitin 2026. Sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe raportit financiar në dispozicion, në vitin 2026 janë planifikuar të hyra vetanake në vlerë prej 4,403,052 euro, ndërsa në vitin 2027 janë planifikuar 3,952,154 euro, që paraqet një rënie prej mbi gjysmë milioni euro. Cila është arsyeja e kësaj uljeje në planifikim? Pyetja e dytë lidhet gjithashtu me Drejtorinë e Financave. Në vazhdimësi, si drejtori ashtu edhe kryetari i komunës kanë theksuar mungesën e mjeteve financiare. Megjithatë, dëshiroj të pyes pse në vitin 2025 komunës i kanë mbetur mjete të pashpenzuara në vlerë prej mbi 500,000 euro, të cilat janë bartur në vitin 2026. Pse këto mjete nuk janë shfrytëzuar gjatë vitit 2025?

Betim Grabanica, anëtar i kuvendit- Kam tre pyetje për Drejtorin e Shëndetësisë. Së pari, kërkoj të na njoftohet se çfarë është duke ndodhur me shërbimet mjekësore dhe bashkëpunimet me institucionet relevante, përkatësisht lidhur me ofrimin dhe funksionimin e këtyre shërbimeve. Së dyti, kërkoj të na informoni se sa janë borxhet e Komunës ndaj Bashkësisë Islame lidhur me shërbimet e varrezave. Së treti, kërkoj të na jepet informacion se sa janë borxhet e Komunës ndaj organizatës së z. Halil Kastrati për ndërtimin e shtëpive dhe qendrave të banimit. Do të doja që këto informata të na ofrohen të shkruara për seancën e ardhshme.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari i Komunës



INFORMATË
LIDHUR ME ZBATIMIN E VENDIMEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
PËR PERIUdhËN JANAR – QERSHOR 2026

Korrik 2026

Bazuar në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026, paraqitet kjo Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2026, si në vijim:

Janar 2026						
Nr	Vendimet e miratuara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për themelim të Komitetit për Komunitete	√				Rishqyrtim i vendimit sipas kërkesës së MAPL-së
2	Vendim për publikimin e listës së pronave publike të paluajtshme për dhënie në shfrytëzim	√				Rishqyrtim i vendimit sipas kërkesës së MAPL-së
3	Vendim për emërimin e komisionit të aksionarëve në NPL “Përparimi” në Vushtri.	√				
4	Vendim për emërimin e komisionit të aksionarëve në KRM “Uniteti” në Vushtri	√				
5	Vendim për miratimin e nismës për ndryshim plotësim të Statutit të Komunës.	√				
6	Vendim për formimin e komisionit për ndryshimin		√			

	dhe plotësimin e Statutit të Komunës.					
7	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e tabelave buxhetore për vitin 2026	√				
8	Vendim për aprovimin e Planit për Transparencë Komunale	√				

Shkurt – 2026						
Nr	Vendimet e miratuara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për Pronën e Spitalit në Vushtri	√				
2	Vendim për caktimin e anëtarëve në kuvendin e Asociacionit të komunave të Kosovës	√				

Mars – 2026						
Nr	Vendimet e miratuara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për publikimin e listës së pronave komunale për vitin 2026	√				
2	Vendim për emërimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave	√				
3	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin të vendimit për themelimin e komitetit për komunitete	√				Rishqyrtim sipas kërkesës së MAPL-së

Prill – 2026						
Nr	Vendimet e miratuara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës në rrugën “Ismajl Parduzi” në Vushtri	√				
2	Vendim për korrigjimin e vendimit për themelimin e komitetit për komunitete.	√				

3	Vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së kuvendit		√			

Maj 2026						
Nr	Vendimet e miratuara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi	√				
2	Vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026	√				
3	Vendim për aprovimin e raportit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore	√				
4	Vendim për ndarjen e çmimit “Emblema e Vushtrrisë” me rastin e shënimit të ditës së çlirimit.	√				

5	Vendim për ndarjen e çmimit “Nderi i qytetit” me rastin e shënimit të ditës së çlirimit	√				
---	---	---	--	--	--	--

Qershor 2026						
Nr	Vendimet e miratuara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore 2027-2029					Në procedurë të vlerësimit të ligjshmërisë në MAPL
2	Vendim për shfuqizimin e vendimit lidhur me pronën e komunale që është dhënë më herët në shfrytëzim					Në procedurë të vlerësimit të ligjshmërisë në MAPL

Sqarim: Për Vendimet tjera të muajit qershor 2026 ende nuk është kthyer nga MAPL përgjigje lidhur me ligjshmërinë.


Siç shihet nga të dhënat e mësipërme në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 janë miratuar gjithsejtë 23 vendime, nga të cilat janë zbatuar 19, në procedurë të zbatimit janë 2 vendime si dhe 2 tjera janë në procedurë të vlerësimit në Ministrinë e Pushtetit Lokal.

Ferit Idrizi


Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATA/DATUM/DATE	14.07.2026
PËR/ZA/TO:	KPF-Kuvendin e Komunës së Vushtrris
Përmes:	<i>per</i> Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi
Nga/OD/FROM	Isuf Jashari, Drejtor i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2026

Të nderuar

Duke u bazuar në planin e punës për vitin 2026 Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa ju prezanton Raportin Janar-Qershor 2026 ,Raporti është i bazuar në planin buxhetor dhe planin e rrjedhës së parasë publike për vitin 2026.

Shtojcë:Tabelat buxhetore

Emri i Komunës :	K.K.VUSHTERRI								
Kodi i Komunës:	644								
Periudha raportuese Janar - Qershor 2026									
TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK									
KK	VUSHTERRI	RAPORTI MUJOR I TE HYRAVE VETANAKE Janar-Maj 2026							
			JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	S	TOTALI
#NAME?	1 Admin.		1,760.00	1,433.00	1,435.00	1,759.00	1,557.00		7,944.00
	2 Ndrim emri mbiemri		2,603.00	2,290.00	2,222.00	2,150.00	1,390.00		10,655.00
	3 Taksat e firmave								
Buxheti	4 Tatimi ne pron.		28,941.39	16,702.19	13,591.39	183,989.42	100,468.56		343,692.95
	5 Te tjera								
	7 Partidpim q. efemijave		13,796.00	13,466.00	11,496.00	13,012.00			67,576.00
Arsimi	8 SH. M. T		15,200.00	4,290.00	732.00	50.00	350.00		20,622.00
	9 SH.M.P		5,110.00	4,780.00	6,490.00	2,000.00	900.00		19,400.00
	10 Shitja e produk. bujqesore								
	11								
Gjeodezi e	12 RDP (Matja e tokave)		9,453.00	6,244.00	7,328.00	8,223.00	5,696.00		36,944.00
Kataster, Pronë	16 Qiraj nga objektet pub.		1,858.02	676.00	3,209.68	8,268.00	1,938.84		15,950.54
	17 Palestra sportive		12.00	50.00	14.00				76.00
Kultur ,fimi.Sport	18 Biblioteka M.-L.K-Sm								
	19 Shtepla e Kultures								
	20 Ndajja e vet.rrugë		336.00	631.75	548.00	800.00	520.00		2,835.75
Sher.pubil.	21 Regjistrim i automjeteve		15,230.00	14,420.00	16,770.00	16,055.00	15,790.00		78,265.00
	22 Taksat e mbeturinave		81,214.27	159,147.75	54,973.40	84,188.80	53,008.10		432,532.32
Prokurim	23 Prokurimi								
	Gjohat e pyjeve								
	24 Shitja e drujve								
	25 Partidpim bujqesia								
Ekonomi, Bujqesi	26 Ndrim i tokes bujqesore		777.00	3,552.00	17,158.00	5,629.00	3,689.00		31,005.00
	Leje pune								
	27 Partidp. D.shënd.								
Shendet.	28 Qend.per pun. Sociale				2,329.00	442.00	260.00		3,031.00
	29 Pranimet Teknike		200.00	1,080.00	665.00	155.00	380.00		2,480.00
Drje Inspeksionit	30 Gjohat e Inspeksionit		100.00	50.00		100.00	425.00		675.00
	31								
	32 Leje ndertimi		53,608.15	38,090.22	35,066.34	107,676.04	50,480.73		284,921.48
	Leje mjedisor			6,386.36	13,342.45				19,728.81
Urbanizmi	Legalizim i objektet		355.33	618.68	494.00	2,160.40	26,384.66		30,013.07
	Rrenim i objekteve			148.68		82.32	994.87		1,225.87
	33 Shf. Prko.pro. Publike		72.00	154.50	72.00	312.00			610.50
	34 Gjohat e Trafikut								
	35 Gjohat e Gjyqates								
	36 Gjohat e pyjeve te policise								
	37 Donacion			5,143.00					5,143.00
	38 Kthim mjeteve								
Totali			234,599.16	285,083.13	195,112.26	443,291.98	281,108.76		1,439,195.29

[illegible]

Sqarim: Sipas kategorive të shpenzimeve buxheti i planifikuar për periudhen Janar-Qershor 2026, Realizimi është 20.673.633,00 Realizimi i shpenzimeve është 19.947.094,36 euro Realizimi 96%.

Emri i Komunës:

Kodi i Komunës:

Periudha raportuese

Shpenzimet Mallra dhe Shërbime dhe Subvencione

KODI	PËRSHKRIMI	Janar - Qershor 2026	Janar - Qershor 2025
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	4,537.10	
13131	Para xhepi/ medijet për udhëtime zyrtare brenda vendit	847.80	64.00
13132	Akomodimi i udhëtimit zyrtar brenda vendit		
13133	Shpenzimet e tjera të-udhëtimit zyrtar brenda vendit		
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	12,882.40	1,590.00
13141	Meditja e udhëtimit zyrtar jasht vendit	5,388.80	3,221.76
13142	Akomodimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	6,500.00	2,651.14
13143	Shpenzimet tjera e udhëtimit zyrtar jasht vendit	11,043.36	7,908.10
13310	Shpenzimet për internet	7,097.35	2,628.89
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	17,950.52	16,081.68
13330	Shpenzimet postare	10,268.07	314.00
13340	Shërbimet për kablo optike	995.00	
13410	Shpenzimet e arsimit dhe trajnimit	14,275.00	41,019.60
13420	Shpenzimet e perfaqësimit avokaturw		12,423.19
13430	Shërbime të ndryshme shendetësore	5,005.02	5,989.94
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	12,535.00	7,756.45
13445	Shërbimet e veçanta-konsulen dhe kontraktorë	5,215.00	
13450	Shërbime shtypje jo marketing	6,972.00	
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	1,905,384.50	3,111,227.91
13470	Shërbime teknike	24,964.71	15,015.08
13480	Shpenzimet për antarsim	13,980.50	25,240.25
13501	Mobilje (më pak se 1000 euro)	393.00	19,145.50
13502	Telefonat		
13503	Kompjuterët	86,529.00	2,527.00
13504	Pajisje tjera të teknologjisë		8,410.00
13508	Pajisjet e trafikut	236.24	
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	38,918.93	73,548.24
13610	Furnizime për zyrë	81,698.38	46,059.80
13611	Furnizim me dokumenta blanko	50.00	3,061.90
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	53,812.11	31,321.06
13630	Furnizime mjekësore	66,509.30	31,062.58
13640	Furnizime pastrimi	30,713.98	22,835.06
13650	Furnizim me veshmbathje		
13655	Furnizim me preparate kimike	2,292.25	1,596.50
13710	Vaj	750.00	9,450.00
13720	Nafte për ngrohje qendrore	18,103.80	
13760	Dru	187,384.90	207,726.36
13770	Derivate për gjenerator		
13780	Karburant për vetura	45,233.83	23,195.62
13790	Gas natyror		
13810	Avanc për para të imëta	3,300.00	2,800.00
13820	Avanc për udhëtime zyrtare	7,012.89	6,812.03
13918	Provizion bankare	1,101.50	8,849.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	2,080.00	3,973.34
13951	Sigurimi i automjeteve	6,432.83	1,211.95
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve	610.16	630.00
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	21,669.00	23,150.78
14020	Mirembajtja e ndërtesave		
14022	Mirembajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	2,749.00	

14023	Mirembajtja e shkollave	19,727.00	43,135.00
14024	Mirembajtja e objekteve shëndetësore	256.90	15,352.00
14032	Mirembajtja e auto rrugëve lokale	1,012,149.68	436,473.85
14040	Mirembajtja e teknologjisë informative		
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve	35,468.42	38,498.00
14060	Mirembajtja rutinore	262,561.60	
14110	Qiraja pwr ndwrtesa	600.00	750.00
14130	Qiraja - pajisjet	9,314.56	4,848.12
14140	Qiraja makineria		19,070.40
14160	Qiraja per automjete	30,512.64	
14210	Reklamat dhe konkurset	875.00	1,135.00
14220	Botimet e publikimeve	1,557.00	
14230	Shpenzimet per informim publik	3,400.00	4,506.00
14310	Kompenzimi i pwrfaqwsimit brenda vendit	13,222.65	21,839.55
14320	Kompenzimi i pwrfaqwsimit jashtw vendit		540.00
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	228,656.26	425,382.99
14510	Pagesa e tatimit në qira		
14415	Pagesa pwr tarifat vendime gjyqesore - permbarimore	252.75	16,662.50
14450	Pagesat, gjobat nderinstitucionale	965.00	
13 TOTALI PËR MALLRA DHE SHËRBIME		4,342,942.69	4,808,692.12

14			
13210	Rryma	409,226.04	211,223.56
13220	Uji	53,463.41	28,274.02
13230	Mbeturinat	16,525.10	17,570.00
13250	Shpenzimet telefonike	2,214.37	5,240.63
13260	Pagesa-vendime gjyqësore	17,049.86	24,600.00
HPENZIMEVE KOMUNALE		498,478.78	286,908.21

20	SUBVENCIONET		
21110	SUBVENCIONET PËR ENTITETET PUBLIKE	141,160.00	85,174.86
21200	SUBVENCIONET PËR ENTITETET JOPUBLIKE	225,362.82	272,683.29
22110	TRANSFERET PËR ENTITETET PUBLIKE	60,978.33	29,450.00
22202	TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË	583,891.63	414,370.00
22203	LIBRAT PER NXENES	300.00	
22298	PAGESAT PER SHËRBIMET E VARRIMIT	9,720.00	51,600.00
22299	QIRAJA PËR RASTET SOCIALE	7,200.00	600.00
22300	VENDIMET GJYQËSORE	1,008,232.59	377,691.00
23110	PAGESAT PER SEKTORIN E BLEGTORISE	147,416.25	
23130	PAGESAT PER KULTURAT BUJQËSORE	13,200.00	
23220	MENAXHIMI I BURIMIT TË UJITJES PËR BUJQËSI		42,594.74
21200	TRANSFERE PER PËRFITUES INDIVIDUAL.		
20 TOTALI I SUBVENCIONEVE		2,197,461.62	1,274,163.89

Pershkrimi	BUXHETI	SHPENZIMI PËR PERIUDHËN	MJETE E LIRA	PERQINDJA E REALIZIMIT TË BUXHETIT
RESP / SUBCL / PCLASS / PROJ	A	C	A - (C + D)	E
644 VUSHTRI	5,621,622.24	3,961,198.99	1,349,344.97	70.46
30 PASURITE JOFINANCIARE	5,621,622.24	3,961,198.99	1,349,344.97	70.46
17524 BUXHETI - VUSHTRI	332.00	0.00	332.00	0.00
60405 ASFALTIMI I RRUGES PANTIN-ASHLAN	331.00	0.00	331.00	0.00
60413 RIPARIM SHF KRASNQ.POSHTE	1.00	0.00	1.00	0.00
18024 SHERBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE - VUSHTRI	1,246.59	0.00	1,246.59	0.00
71935 RREGULLIMI I SHESHIT HSAN PRISHTINA	37.00	0.00	37.00	0.00
72228 RREGU RRUGES BAHRI KUQI SEG.1	375.52	0.00	375.52	0.00
83124 FOND BASHKËFIN. SHTRI RR. KUBEZA	2.00	0.00	2.00	0.00
86140 FONDI I BASHKËFINANCIMIT SHTRIRUAJE RRUGË ME KUBE	728.07	0.00	728.07	0.00
93129 FTK PER RR NE L.BUN SOP F.SAMA	104.00	0.00	104.00	0.00
18184 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - VUSHTRI	1,330,938.58	975,749.76	351,188.82	73.61
00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQESORE (NEW 40 LMFPP)	223,511.00	223,286.51	224.49	99.90
47826 NDERTIMI STACIONIT TE AUTOBUSEVE	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
51819 Ndertimi i kanalizimeve ne Vushtri, Shadrexhe, Maxharuzaj, S	125,000.00	100,000.00	25,000.00	80.00
51826 Blerja e veturave per administraten komunale - Vushtri	80,000.00	70,000.00	10,000.00	87.50
53182 NDERTIMI I KANALIZIMIT NE PESTOVE	15,000.00	12,000.00	3,000.00	80.00
53193 NDERTIMI I KANALIZIMIT NE GOJUBULE	15,000.00	12,000.00	3,000.00	80.00
53220 NDERTIMI I KANALIZIMIT NE STANOC TE EPERM, STANOC TE POSHTEM	25,000.00	20,000.00	5,000.00	80.00
53226 NDERTIMI I KANALIZIMIT NE MIHALIQ	15,000.00	12,000.00	3,000.00	80.00

53231	NDERTIMI I KANALIZIMI NE AKRASHTICE - BALANCE	25,000.00	20,000.00	5,000.00	80.00
53239	NDERTIMI I KANALIZIMIT NE PANITINE-OSHLAN	15,000.00	12,000.00	3,000.00	80.00
53374	NDERTIMI I URES NE LUMMADH	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
53603	NDERTIMI I KANALIZIMI NE KOLLE	10,000.00	8,000.00	2,000.00	80.00
54893	NDERTIMI E RR. ME KUB BETONI BESHIR KRASHNIQI, JASHAR JASHARI	124,837.00	0.00	124,837.00	0.00
54917	NDERTIMI I TROTUAREVE FSHATI DOBERLLUKE, STANOC, AKRASHTICE,	14,924.00	0.00	14,924.00	0.00
54946	NDERTIMI I STACIONIT TE POMPIMIT, RRJETIT PRIMAR REZERVUAREV	476,489.00	453,463.25	23,025.75	95.17
56322	Ndertimi i kanalizimit ne Druar	15,000.00	13,000.00	2,000.00	86.67
56325	Ndertimi i kanalizimit ne Banjске	15,000.00	12,000.00	3,000.00	80.00
56330	Ndertimi i kanalizimit ne Shalle	15,000.00	12,000.00	3,000.00	80.00
56358	Ndertimi i vjete ne Novolan dhe shetitoret	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
57167	NDERTIMI I PARKUT TE "DYNEKU"	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
92060	NGRITJA E PERFORMANCES 2019	3,985.65	0.00	3,985.65	0.00
92111	PERFORMANCA KOMUNALE 2021	6,285.73	0.00	6,285.73	0.00
93195	NDERT PIK PRITESE PER AUTOB-PRI-ZHI-BIV-STR	906.20	0.00	906.20	0.00
47024	BUJQESIA - VUSHITRI	894,789.00	361,464.86	533,324.14	40.40
00040	EKZEKUTIMI I VENIMEVE GJYQESORE (NEW) 40 LWFPP)	200,796.00	200,432.00	364.00	99.82
48182	NGRITJA E PEMISHTEVE.	991.00	0.00	991.00	0.00
49561	PROJEKTET NE BASHKEFINANCIM ME DONATORE	438,000.00	0.00	438,000.00	0.00
52290	RREGULLIMI DHE PASTRIMI I LUMIT LLAP-SILNICA	155,000.00	61,032.86	93,967.14	39.38
56362	Rregullimi dhe pastrimi i lumit "Silnica" Vushitri- Smrkoni	100,000.00	100,000.00	0.00	100.00
81152	NGRITJA E SERAVE	2.00	0.00	2.00	0.00

66425 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - VUSHTRI	2,576,358.00	2,145,988.73	300,359.27	83.30
00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQESORE (NENI 40 LMFPF)	689,503.66	689,241.30	261.76	99.96
53207 NDERTIMI I RRUG. "BEKIMI BERISHA ABEJA"	79,018.34	49,018.34	30,000.00	62.03
53262 NDERTIMI I RRUG. "AVNI SARAQI" VICIANA	12,600.00	12,600.00	0.00	100.00
53274 RREGULLIMI I RR. "ISAK HALILI" ME INFRASTRUKTURE PERCJELLESE	100,000.00	0.00	100,000.00	0.00
53276 NDERTIMI I RRUG. "LUMINI SURDULLI"	72,011.00	62,011.00	10,000.00	86.11
53344 RIKONSTRUIMI I BULEVARDIT "ADEMI JASHARI" DHE LIDHJA ME	483,511.00	373,413.49	110,097.51	77.23
54750 REHABILITIMI I RRUGEVE NE VERRINCE. SHALLC. AKRASHTICE. BUKOS	90,000.00	90,000.00	0.00	100.00
54754 REHABILITIMI I RRUGEVE NE SMREKONICE. DOBERLLUKE. SLLATINE. P	40,000.00	40,000.00	0.00	100.00
54775 REHABILITIMI I RRUGEVE NE BIVOLAK. ZHILVODE. STROC	90,000.00	90,000.00	0.00	100.00
54798 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE DUNNICE. MAXHUNAJ. STANOC. LUV	110,000.00	110,000.00	0.00	100.00
54799 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE GRACE. PRELLUZE	80,000.00	80,000.00	0.00	100.00
54801 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE STUDIME E ULET. CECELI. SAVADRE	220,000.00	220,000.00	0.00	100.00
54820 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE STROC. BEQUK. GILLAVOTIN. BIVOL	140,000.00	140,000.00	0.00	100.00
54834 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE BECQ. DUBOC	70,000.00	70,000.00	0.00	100.00
56296 Ndertimi i rruges Staracak te varrezat	94,714.00	94,714.00	0.00	100.00
57168 RINDERTIMI DHE ZGJERIMI I RRUGEVE ME INFRASTRUKTURE PERCJELL	25,000.00	25,000.00	0.00	100.00
57169 NDERTIMI I RRUG. "2 MAJIT" ME INFRASTRUKTURE PERCJELLESE - STUD	180,000.00	0.00	50,000.00	0.00
74450 SHERBIKET E KUDESIT PRIMAR SHENDETESOR. VUSHTRI	84,428.00	0.00	0.00	0.00
57171 DEPO PER OBJEKTE SHENDETESORE. VUSHTRI	84,428.00	0.00	0.00	0.00
75617 SHERBIMET REZIDENCIALE. VUSHTRI	245,000.00	229,879.92	120.08	93.83
00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQESORE (NENI 40 LMFPF)	230,000.00	229,879.92	120.08	99.95

53625 BLERJA E VETURES PER SHERBIMET REZIDENCIALE	15,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00
57177 SHTIEPIA E KOMUNITETIT PER PERSONA TE MOSHUAR -VUSHTRI	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
85024 SHERBIMET KULTURORE - VUSHTRI	332,040.02	244,105.72	87,040.02	73.52	
52825 RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I OBJEKTIT "ARKIVI I VJETER" ISH F	41,000.00	34,105.72	6,000.00	83.18	
54727 RREGULLIMI I MEMORIALEVE NE GLLAVOTIN, REZNIK, BEÇIQ, DUBOC.	91,040.00	70,000.00	21,040.00	76.89	
54735 NDERTIMI/KONSTRUIMI I FUSHAVE SPORTIVE MAXHUNAJ, LUMMADH.	200,000.00	140,000.00	60,000.00	70.00	
92060 NGRITJA E PERFORMANCES 2019	0.02	0.00	0.02	0.00	
92670 ARSIMI PARAFILLOR CERDHEI - VUSHTRI	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00	
57174 NDERTIMI I QERDEHEVE (DYTET, LUMMADH, SMREKONICE, MAXHUNAJ,	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00	
93690 ARSIMI FILLOR - VUSHTRI	145,756.00	0.00	65,000.00	0.00	
53024 NDERTIMI I SHFNU "MUSTAF VENHARI "	100,756.00	0.00	20,000.00	0.00	
56941 NDERTIMI I SHFNU "EMIN DURAKU" - NOVOLAN	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00	
57172 NDERTIMI I SHKOLLES "NAIM FRASHERI" - VUSHTRI	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00	
57173 NDERTIMI I SHKOLLES "7 MARS" BUKOSH	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00	
94890 ARSIMI I MESEM - VUSHTRI	734.05	0.00	734.05	0.00	
93222 RREGULLIMI I SHKOLLES BAHRI HAXHA	577.05	0.00	577.05	0.00	
95104 FURNIZIMJETE PER PUNTOR SILDATOR. AXHUSTATOREVE	157.00	0.00	157.00	0.00	
Totali i Pergjithshëm	5,621,622.24	3,961,198.99	1,349,344.97	70.46	

Sqarim:Përmbledhia e shpenzimeve sipas kategoris ekonomike në investime kapitale është si vijon:
Buxheti i planifikuar në investime kapitale për vitin 2026 është 5,621,622.24euro ,realizimi është 3,961,198.99euro,apo 70.46% realizimi ,shuma e mbetur për periudhat në vijimë në vlerë 1,349,344.97euro,jonë në procedurë të realizimit.
Vrejte:Për dallim nga vitet të tjera të investimet kapitale,theksoj se në vitin 2026 ,Ministria e Punës dhe Transfereve ka hapur kodin ekonomik ekonomik 00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE (NENI 40 LMFPP),dhe nga projektet e planifikuara kan ekzekutuar shumën 2,205,388.36euro
Gjithsej në këtë gjashmujor jonë shpenzuar shuma2,388,828.46euro.
për Vendime Gjyqësore Përmbartimore.



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	14.07.2026
PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin Komunal
NGA/OD/FROM;	Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare për Vitin 2025

Bazuar në Procedurën Standarde të Operimit për trajtimin e të Gjeturave të ZKA, Kryetari i Komunës e dërgon Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare për Vitin 2025, për diskutim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvend.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë (VU), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vushtrrisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Raportimi mbi detyrimet kontigjente, i shpalosur ne PVF, ishte mbivlerësuar për 1,568,004€.
- B2 Shpenzimet e prezantuara ne PFV në vlerë totale 1,187,376€ nuk janë klasifikuar në kategoritë e duhura ekonomike që janë raportuar ne kategori te gabuara buxhetore, duke ndikuar në mbivlerësimin/ nënvlerësimin e kategorive ekonomike adekuate.
- C1 Pasuritë jofinanciare të shpalosura në pasqyrat vjetore financiare janë nënvlerësuar për 112,732€.
- B3 Obligimet e papaguara të shpalosura në pasqyrat vjetore financiare janë mbivlerësuar për 74,427€.
- B4 Llogaritë e arkëtueshme të shpalosura në pasqyrat vjetore financiare janë mbivlerësuar për 26,231€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Vushtrrisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Vazhdimi i kontratës së skaduar të punës pa procedurë të re të rekrutimit.
- A2 Mangësi në procesin e subvencionimit për renovimin e banesave kolektive.
- A3 Mangësi në menaxhimin e kontratave të punëve.
- B5 Dhjetë (10) fatura në vlerë totale 686,513€, nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditësh nga data e pranimi.
- B6 Gjatë vitit 2025 Komuna nuk ka bërë verifikimin e pronave të paluajtshme që i nënshtrohen tatimit në pronë.
- B7 Mos pagesa e rregullt e qirasë nga shfrytëzuesit e pronave publike.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Vushtrrisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Vushtrrisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Vushtrrisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Vushtrrisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Vushtrrisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Kontrollet e brendshme duhet të avancohen tutje me qëllim që informatat financiare të prezantohen drejt dhe saktë në PVF, duke përfshirë klasifikimin adekuat të shpenzimeve, si dhe shpalojet e informatave për pasuritë jofinanciare, detyrimet kontigjente, obligimet e papaguara dhe llogaritë e arkëtueshme. Në aspektin e pajtueshmërisë, përmirësime janë të nevojshme si në menaxhimin e duhur dhe realizimin me kohë të kontratave publike, menaxhim të personelit, proceset e subvencionimit, çertifikim të pagesave, menaxhimin e tatimit në pronë dhe arkëtimin me kohë të të hyrave vetanake.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 16 rekomandime, prej tyre 4 janë rekomandime të reja dhe 12 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente në pasqyrat vjetore financiare

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF nr.01/20217, për raportim vjetor financiar, përcakton që OB-të duhet të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Gjithashtu, neni 18 i Rregullores, obligon OB-të në harmoni me LMFPF-në të raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Detyrimet kontigjente të prezantuar në pasqyrat vjetore financiare ishin mbivlerësuar për 1,568,004€. Komuna kishte pranuar propozimet përmbartimore për obligimet e tilla ndaj kontraktuesve, dhe nuk kishte bërë prapësimin e këtyre propozimeve për përmbartim, duke mos vazhduar me rastet e tilla në procedurë gjyqësore.

Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë në përditësimin e informatave në regjistrin e kontingjencave dhe prezantimin e duhur financiar.

Ndikimi Mos përditësimi i informatave në regjistrin e detyrimeve kontigjente ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e pasqyrave vjetore financiare të mos informohen drejtë për vlerën e detyrimeve kontigjente që ka komuna.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që detyrimet kontigjente të shpalosura në

pasqyrat vjetore financiare, të mos përfshijnë urdhërat përmbarimor për realizimin e pagesave, e për të cilat nuk ka konteste gjyqësore me palët kontraktuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate

Gjetja

Me Ligjin nr. 08/L-332 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, neni 5, janë miratuar ndarjet buxhetore për kategoritë ekonomike përkatëse për secilën organizatë buxhetore. Gjithashtu, Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF- Shpenzimi i parave publike, neni 18, pika 3, përcakton që shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me udhëzimin administrativ për planin kontabël. Me planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar saktë kategoritë ekonomike dhe kodet përkatëse prej nga duhet të realizohen pagesat e shpenzimeve sipas secilit lloj.

Pagesat në vlerë totale 1,187,376€ nuk janë klasifikuar në kategorinë e duhur ekonomike. Keqklasifikimet kanë rezultuar te këto kategori ekonomike:

- Për shpenzime që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve, të cilat kanë të bëjnë me pagesat për kontratën kolektive të punonjësve të arsimit, janë paguar 428,105 nga buxheti i kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, 407,137€ nga buxheti i kategorisë së investimeve kapitale, dhe 129,000€ nga buxheti i kategorisë së subvencioneve.
- Për shpenzimet që i takojnë kategorisë së investimeve kapitale janë paguar 223,134€ nga buxheti i kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Sipas regjistrimit të siguruar nga Komuna, gjatë vitit 2025, si rezultat i procedurave përmbarimore dhe vendimeve gjyqësore nga paditë e punonjësve të arsimit për kompensimet ndërlidhur me kontratën kolektive, dhe kontraktuesve (furnitoreve) në emër të kamatave, tarifave të përmbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore janë paguar kosto shtesë në vlerë 687,855€.

Kjo ka ndodhur për shkak të pagesave nga Thesari si rezultat vendimeve gjyqësore të ndërlidhura me kontratën kolektive për punonjësit e arsimit, si dhe planifikimeve të gabuara buxhetore.

Ndikimi

Regjistrimi i shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që gjatë hartimit të qarkoreve buxhetore, shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo në koordinim me Ministrin e Financave të shihen mundësit e ridestinimit të mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet nga kategoritë ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Nënvlërësim i pasurisë jofinanciare në pasqyrat vjetore financiare

Gjetja Rregullorja MF-nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në OB, neni 6, paragrafi 3, përcakton që: pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-Pasuria.

Pesë (5) pagesa për investime kapitale në vlerë totale 95,416€ nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë në SIMFK, dhe gjashtë (6) pagesa për blerjet e pasurive jokapitale në vlerë 17,316€ nuk janë regjistruar në programin e-Pasuria. Si rezultat, pasuritë jofinanciare të shpalosura në PVF janë nënvlërësuar në total për 112,732€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në regjistrimin e pasurisë në sistemet përkatëse.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive jofinanciare reflekton në regjistra të pasaktë të pasurisë, rrit rrezikun e humbjeve apo menaxhimit jo adekuat të tyre,

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme efektive që të gjitha pasuritë jofinanciare të regjistrohen në kohë dhe në mënyrë të saktë në regjistrin kontabël të pasurisë në SIMFK dhe në sistemin e-Pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Mbivlerësim i obligimeve të papaguara në pasqyrat vjetore financiare**

Gjetja Neni 6 i Rregullores nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, përcakton që, OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare.

Gjashtë (6) fatura në vlerë totale 74,427€ të cilat ishin paguar gjatë vitit 2025, ishin prezantuar si obligime të papaguara në pasqyrat vjetore financiare.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në menaxhimin dhe përditësimin e regjistrit të obligimeve të papaguara nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi Mbivlerësimi i obligimeve financiare, përveç që ndikon në shpalosje të informatave të pasakta për shfrytëzuesit e pasqyrave financiare, reflekton edhe në planifikime buxhetore jo të drejta për pagesën e tyre në vitin vijues,

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle adekuate rreth përditësimit të regjistrit të obligimeve dhe që faturat e pranuar apo obligimet financiare të prezantohen saktë në pasqyrat vjetore financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme në pasqyrat vjetore financiare

Gjetja Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga OB-të, neni 6, përcakton që: OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Gjithashtu, sipas Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 10, paragrafi 1 përcakton se: Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të: pika 1.1. Institucioneve publike të Republikës së Kosovës.

Në regjistrin e llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë, është ngarkuar me tatim në pronë parcela publike që është në pronësi komunale, duke mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme për 26,231€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme ndikon në prezantim jo të saktë të informatave në raportin vjetor financiar të komunës dhe që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën tyre,

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që pronat komunale të mos ngarkohen me tatim në pronë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vazhdimi i kontratës së skaduar të punës pa procedurë të re të rekrutimit

Gjetja

Sipas Rregullores (QRK) nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA), neni 10 përcakton se konkursi për një periudhë të caktuar shpallet në rastet e zëvendësimit të përkohshëm të një nëpunësi, ngarkesës së përkohshme të punës apo për projekte me kohëzgjatje të caktuar. Ndërsa, sipas nenit 31, për këto angazhime lidhet kontratë pune për periudhë të caktuar, duke specifikuar datën e fillimit dhe përfundimit të saj.

Komuna e Vushtrrisë ka zhvilluar një procedurë rekrutimi dhe ka lidhur kontratë pune me afat të caktuar me një mësimdhënëse, me qëllim zëvendësimin e përkohshëm të një mësimdhënëse që ishte në pushim të lehonisë. Me kthimin e mësimdhënëses të rregullt në vendin e saj të punës, e drejta e kontratës me afat të caktuar ka pushuar. Megjithatë, mësimdhënësjë e angazhuar me kontratë me afat të aktuar është transferuar në një shkollë tjetër për të zëvendësuar një tjetër mësimdhënëse, pa zhvilluar një procedurë të re rekrutimi.

Kjo ka ndodhur nga mosrespektimi i kufizimeve ligjore për përdorimin e kontratave me afat të caktuar vetëm për qëllimin për të cilin janë shpallur, si dhe mungesa e inicimit të procedurës së re të rekrutimit për pozitën e krijuar rishtazi, duke vazhduar angazhimin jashtë kornizës fillestare të kontratës.

Ndikimi

Shkelja e dispozitave ligjore që rregullojnë angazhimet me afat të caktuar, cenimi i parimit të konkurrencës dhe transparencës në punësimin publik, si dhe rreziku i krijimit të praktikave jo të rregullta në transferimin dhe angazhimin e stafit, ndikojnë në dobësimin e kontrollit të brendshëm në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e rrezikut për mosrespektim të procedurave ligjore në fuqi.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që angazhimet e punonjësve me kontratë me afat të caktuar realizohen vetëm brenda qëllimit, kushteve kontraktuale dhe afatit të përcaktuar. Çdo ndryshim i pozitës apo angazhimit të ri, të bëhet përmes procedurës së re të rekrutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në procesin e subvencionimit për renovimin e banesave kolektive**Gjetja**

Sipas Rregullës Financiare nr. 01/2013/MF, neni 36 kërkon që çdo pagesë nga kjo kategori të ketë bazë të qartë juridike dhe, kur i jepet një subjekti të caktuar, të mbështetet me marrëveshje zyrtare. Sipas Ligjit Nr. 03/L-040, Kuvendi i Komunës ka kompetencë të padelegueshme për miratimin e buxhetit dhe çështjeve financiare, ndërsa sipas Rregullores (KKV) nr. 03/2023, ai vendos për bashkëfinancimet kur pjesëmarrja e komunës është 50% ose më shumë e vlerës së projektit. Gjithashtu, me Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Fondeve (DNDF) përcaktohet mënyra e bashkëfinancimit të kontratës publike.

Për kontratën e punëve “Renovimi, izolimi, fasadimi, rikonstruimi i çative dhe bodrumeve të objekteve kolektive dhe Komunale” në vlerë 2,715,335€, mungonte marrëveshja e bashkëfinancimit të punimeve mes Komunës, N.P.L. Përparimi SH.A, dhe Këshillit të banesave të qytetarëve. Me kontratë dhe DNDF, komuna ka specifikuar që punimet do të bashkëfinancohen nga Komuna e Vushtrrisë, N.P.L. Përparimi SH.A, dhe qytetarët, ku pjesëmarrja e komunës në financim është planifikuar të jetë 83% e vlerës. Kjo kontratë e punëve e klasifikuar në kuadër të kategorisë ekonomike Subvencione dhe Transfere, nuk është aprovuar paraprakisht nga Kuvendi i Komunës, duke marrë parasysh se komuna ka pjesëmarrje të konsiderueshme të financimit të punimeve.

Kjo ka ndodhur për shkak të paqartësisë në definimin dhe ndarjes së financimit për përfituesit privat dhe pjesës tjetër që mund ti takojë komunës, si dhe kontrolleve të dobëta të brendshme në fazën e planifikimit dhe aprovimit të projekteve.

Ndikimi

Këto mangësi përbëjnë rrezik për shpenzime pa bazë të qartë ligjore, paqartësi në klasifikimin buxhetor, dhe njëkohësisht edhe në aspektin e raportimit financiar.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë që projektet me bashkëfinancim të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi i Komunës, dhe përmes marrëveshjes së bashkëfinancimit të përcaktohen të drejtat dhe obligimet e secilës palë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në menaxhimin e kontratave të punëve dhe mos vazhdim i sigurimit të ekzekutimit**Gjetja**

Sipas Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, neni 70.23 përcakton që: Menaxheri i kontratës do të sigurojë se kontraktuesi kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë, Gjithashtu, neni 70.24 përcakton që: menaxheri i kontratës duhet të sigurojë që kontraktuesi i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës.

Sipas nenit 63 të LPP-së dhe Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, neni 29, siguria e ekzekutimit (SE) kërkohet si parakusht për nënshkrim të kontratës. Shuma e SE do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës, dhe e njëjta do të mbetet valide për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Gjithashtu me kontratat publike përcaktohet edhe garancioni i kualitetit të punimeve që kontraktuesit duhet të ofrojnë pas përfundimit të kontratës.

Auditimi i menaxhimit të kontratave të punëve ka identifikuar mangësi në menaxhim. Për kontratat publike që ende janë në proces të realizimit, mangësit janë hasur te:

- Kontrata e punëve "Ndërtimi i rrugës 2 Maji me infrastrukturë përcjellëse" pozicioni 1.1 Punët përgatitore për fillimin e punimeve, mobilizimi i punishtës me zyre dhe shenjat e nevojshme për siguri dhe paralajmërim të vendpunishtes, në vlerë, 14,000€, sipas situacionit të punëve për katër zyra në vendpunishte, gjatë verifikimit në terren është konstatuar se nuk është gjetur asnjë zyrë e vendosur në vendpunishte. Nga dëshmitë e siguruara rezulton se edhe në fazat fillestare kishte qenë e vendosur vetëm një zyrë, e cila më pas është larguar.
- Kontrata e punëve "Ndërtimi i shkollës fillore Mustafë Venhari" nga inspektimi i punimeve është identifikuar se pozicioni nr. 14.6, 14.7, 14.8 punimet dhe mbjellja e barit dhe drunjtëve dekorativ për kopsht, në vlerë totale 2,600€ nuk ishin realizuar, por që ishin pranuar si të përfunduara me situacionin e punimeve.
- Kontrata e punëve "Ndërtimi i tregut të gjelbër për prodhuesit vendor" nga inspektimi i punimeve është identifikuar se pozicioni 13.3 Furnizimi dhe mvëshja e basamakëve të shkallëve dhe pushimoreve me pllaka mermeri, në vlerë 3,900€, ishte i papërfunduara, por që ishte pranuar si të përfunduara me situacionin e punimeve.

Gjithashtu, nga auditimi i projekteve kapitale është identifikuar se në katër (4)⁵ kontrata tjera sigurimet e ekzekutimit nuk ishin vazhduar kur projektet kapitale nuk kishin arritë të finalizoheshin sipas afatit të kontratave, derisa në gjashtë (6)⁵ raste tjera të kontratave garancionet e kualitetit të punimeve nuk ishin sjelle pas përfundimit të punimeve.

Kjo ka ndodhur për shkak të monitorimit të pamjaftueshëm nga menaxherët e kontratave dhe mbikqyrësit e drejtëpërdrejt për të siguruar se punimet po realizohen në kohën dhe mënyrën e duhur.

Ndikimi

Parregullësitë e tilla mund të ndikojnë që punimet e papërfunduara të mos realizohen në sasinë dhe cilësinë e duhur. Mos vazhdimi i sigurisë së

ekzekutimit të kontratës nuk garanton mbulimin e dëmeve dhe shpenzimeve në rast të mos përmbushjes së kontratës nga ana e kontraktuesit. Derisa, mungesa e garancioneve të kualitetit të punimeve pamundëson përmirësimet e mundshme në rastet kur furnizimet apo punimet nuk janë realizuar në cilësinë e duhur.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave monitorojnë si duhet realizimin e punimeve, të shtojnë masat e kontrollit, dhe të mos aprovjnë punë apo furnizime të papërfunduara. Në rastet kur kontratat nuk arrijnë të përfundohen në kohën e duhur, sigurimi i ekzekutimit të vazhdohet nga kontraktuesit, derisa për kontratat e përfunduara të ofrohet garancioni i kualitetit të punimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Vonesa në pagesat e obligimeve financiare

Gjetja Neni 41 i Rregullës financiare nr. 01/20213/MF shpenzimi i parasë publike, përcakton që, OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës.

Në dhjetë (10) pagesa për investime kapitale në vlerë totale 686,513€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditësh nga data e pranimit. Vonesat në pagesa ishin nga 1 deri 4 në muaj përtej afatit ligjor.

Gjithashtu, nga raporti i obligimeve të papaguara të muajit dhjetor 2025, janë identifikuar 45 fatura në vlerë totale 2,367,987€, të cilat kishin mbetur pa u paguar deri fund të vitit 2025. Vonesat ishin nga 1 deri në 8 muaj.

Mos pagesa me kohë e obligimeve ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, por edhe për shkak të shpenzimit të buxhetit nga pagesat për vendime gjyqësore.

Ndikimi Vonesa në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, ndikon që komuna të jetë subjekt i padive nga kontraktuesit, duke shkaktuar kosto shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Mos inspektimi i 20% të pronave të tatueshme për tatimin në pronë

Gjetja Neni 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Gjatë vitit 2025 Komuna nuk ka bërë asnjë verifikim të pronave ekzistuese, apo edhe pronave të reja që i nënshtrohen tatimit në pronë.

Në vitin 2025, Komuna ka kontraktuar një kompani për ofrimin e shërbimeve të inspektimit të objekteve me qëllim të tatimit në pronë dhe

shërbimeve për inkasimin e obligimeve të tatimit, por për shkak të çështjeve buxhetore, ka vendosur që deri me aprovimin e buxhetit për vitin 2026 të mos fillohet me punë nga kontraktuesi. Megjithatë, as nga zyra përkatëse e tatimit në pronë, personeli nuk është angazhuar për verifikim të pronave.

Ndikimi

Mos verifikimi i objekteve rezulton me mangësi të informatave aktuale rreth vlerësimit të drejtë të tatimit në pronë, duke ndikuar në pranimet që komuna mbledhë nga kjo kategori e të hyrave.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për verifikim të pronave të paluajtshme. Pronat e reja dhe ndryshimet eventuale të atyre ekzistuese të përfshihen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Mos pagesa e rregullt e qirasë nga shfrytëzimi i pronave publike komunale

Gjetja

Sipas kontratës së qirasë, neni 6 përcakton veprimet nga dështimet për të përmbushur kontratën, përkatësisht kur qiramarrësi ka paafësi të pagesës së obligimit. Gjithashtu, me nenin 2 përcaktohet që në rastin kur qiramarrësi dështon të paguajë në kohë siç është përcaktuar në këtë nen, qiramarrësi ia paguan qiradhënësit një dënim në shumë të kamatës ditore 1% të borxhit total të papaguar.

Shfrytëzuesit e pronave komunale nuk kishin paguar me rregulltë qiranë vjetore. Mangësit janë hasur në këto raste:

- Në kontratën për qira të tokës bujqësore për dhënie të shfrytëzimit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 11,97.88ha, me lokacion në Balincë, në vlerë prej 898.41€ për një vit kalendarik. Si pasojë e mos pagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 5,391€.
- Në kontratën për qira të tokës bujqësore për dhënie të shfrytëzimit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 23,45.12ha, me lokacion në Gracë, në vlerë prej 7,070.53€ për një vit kalendarik. Si pasojë e mospagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 10,301€.
- Në kontratën për qira të tokës bujqësore për dhënie të shfrytëzimit në afat prej më pak se një vit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 23,45.12ha, me lokacion në Gracë, në vlerë prej 5,554.10€ për një vit kalendarik. Si pasojë e mospagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 12,480€.
- Në kontratën për qira të lokalit afarist nr.2 për dhënie të shfrytëzimit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 11m², me lokacion në rr. "Jeton Tërstena" në Vushtrri, në vlerë prej 25.85€ për një muaj. Si pasojë e mospagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,860€.
- Në kontratën për qira të lokalit afarist për dhënie të shfrytëzimit në afat prej shtatë (7) viteve me sipërfaqe të përgjithshme prej 90m² objekt dhe oborr 187m², me lokacion në rr. "Dëshmorët e Kombit", Vushtrri, në vlerë prej 1,000€ për një muaj. Si pasojë e mospagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 30,000€.
- Në kontratën për qira të lokalit afarist për dhënie të shfrytëzimit në

afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 90m² objekt dhe oborr 187m², me lokacion në “Sheshin Hasan Prishtina”, Vushtrri, në vlerë prej 1,102€ për një muaj. Si pasojë e mospagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 9,980€.

Kjo ka ndodhë për shkak të kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme, dhe mungesës së një mekanizmi efektiv për monitorimin e procesit të pronave komunale të cilat janë dhënë me qira.

Ndikimi

Mos pagesa e qirasë nga shfrytëzuesit e pronave komunale ndikon negativisht në fondin buxhetor të komunës. Mos marrja e veprimeve ligjore ndaj qiramarrësve të pa përgjegjshëm mund të inkurajojë të njëjtit dhe qiramarrësit tjerë të mos përmbushin fare obligimet kontraktuale.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë që janë vendosur kontrolle efektive për monitorimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim. Për qiramarrësit të cilët nuk përmbushin me kohë kushtet e kontratës, të aplikohen penalet për mos pagesën me kohë, apo të shqyrtohet mundësia e ndërprerjes së kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,855,000€, dhe gjatë vitit 2025 ishin shpenzuar 1,853,969€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionimin e entiteteve publike dhe jopublike, financimin e OJQ-ve për projekte në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, por edhe transfere për përfitues individual.

Çështja B8 - Mangësi në raportim dhe monitorim të projekteve të subvencionuara

Gjetja

Me Rregulloren MF nr - 04/2017 Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 23 përcakton që: Përfituesi raporton te zyrtari monitorues, përkatësisht ekipi monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit, sipas kërkesave të kontratës së përcaktuar në nenin 22 të kësaj Rregulloreje. Raportimi përfshin raporte narrative dhe financiare dhe periudhat raportuese do të përcaktohen me dispozitat e kontratës me përfituesin.

Për subvencionimin e projektit "Promovimi i sportit / marrja me aktivitete sportive, ndikimi i tyre në shëndetin e njeriut" në vlerë prej 5,200€, përmes thirrjes së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, OJQ përfituese nuk ka dorëzuar raport narrativ dhe financiar rreth realizimit të projektit. Po ashtu, sipas raportit të komisionit monitorues, edhe pse disa OJQ përfituese kanë dorëzuar raportet narrative dhe financiare, asnjëra prej tyre nuk ka informuar monitoruesit për pjesëmarrje në aktivitetet që do të realizohen, duke kufizuar mundësinë e verifikimit në terren dhe vlerësimit objektiv të zbatimit të projekteve.

Kjo ka ndodhë për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme për monitorimin e projekteve të subvencionuara nga mbikqyrësit e projekteve.

Ndikimi

Mungesa e monitorimit dhe raportimi i mangët nga përfituesit ndikon në shpenzimin jo efektiv të mjeteve dhe mosarritjes së qëllimit të dedikuar të subvencionimit.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të sigurojë mekanizma të monitorimit dhe raportimit, me qëllimin që përfituesit e subvencioneve të dorëzojnë raporte mbi shfrytëzimin e fondeve publike në afatet e përcaktuara. Përfituesit që nuk përmbushin obligimet për raportim të mjeteve të shfrytëzuara duhet të përjashtohen nga e drejta e përfitimit të subvencioneve në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,977,402€, dhe gjatë vitit 2025 ishin shpenzuar 5,947,019€. Investimet kapitale përbëhen nga investimet në infrastrukturën rrugore, sheshe, lumenjë, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit publik, furnizime me pajisje mjekësore, etj.

Çështja B9 - Vonese ne realizim te projekteve kapitale

Gjetja

Sipas nenit 70.23 të Rregullores nr. 002/2024 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.

Tetë (8) projekte kapitale nuk ishin realizuar në afatin kohor të përcaktuar me kontratë. Rastet janë të këto kontrata, ku punimet deri në kohën e auditimit (prill 2026) nuk janë përfunduar:

- Rikonstruimi i Bulevardit Adem Jashari dhe ndërtimi i parkingut nëntokësor, lot 1, në vlerë 2,713,170€, duhej të përfundonte deri në dhjetor 2025, derisa punimet ende vazhdojnë.
- Ndërtimi i shkollës fillore Mustafë Venhari, në vlerë 1,078,258€, duhej të përfundonte deri në fund të vitit 2025, derisa punimet ende nuk kanë përfunduar në tërësi.
- Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni (kalldrëm), Rr. Pandeli Sotiri, Rr. Shem Nallbani dhe Rr. Hoxhë Kadri Prishtina, në vlerë 147,936€, duhej të përfundonte deri në qershor 2025, punimet ende nuk kanë përfunduar.
- Ndërtimi i rrugës Bekim Berisha - Abeja, në vlerë 778,251.43€, duhej të përfundonte në tetor 2024, punimet ende vazhdojnë.
- Restaurimi dhe konzervimi i ish Arkivit ë vjetër, në vlerë 124,140€, duhej të përfundonte në gusht 2025, punimet ende nuk janë kryer në tërësi.
- Ndërtimi i tregut të gjelbërt për prodhuesit vendor, në vlerë 1,131,057€, duhej të përfundonte në tetor 2025, derisa punimet ende vazhdojnë.
- Ndërtimi i rrugës Lumni Surdulli - lot 2, në vlerë 685,260€, duhej të përfundonte në tetor 2024, derisa punët ende vazhdojnë.
- Renovimi i palestrës sportive Jeton Tërstena në vlerë 48,260€, e nënshkruar në tetor 2023, duhej të përfundonte brenda 40 ditëve, derisa kontrata është përfunduar në qershor 2025.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme nga ana e menaxherëve të kontratave, kontesteve pronësore si dhe mungesës buxhetore të ndodhura nga pagesat e realizuara nga fondi i investimeve kapitale për shkak të vendimeve gjyqësore.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë negativisht në arritjen objektivave të përcaktuara me programin investiv dhe planet vjetore buxhetore.

Rekomandimi B9

Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe

në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B10 - Mos vlerësimi i performancës së kontraktuesve përmes e-Prokurimit

Gjetja

Neni 70, pika 23 dhe 25 e Rregullores 002/2024 për prokurimin publik, përcakton që, menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij, derisa mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për shqyrtimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar në platformën e e-prokurimit.

Nga testimet konstatuam se për nëntë (9)⁶ kontrata publike të përfunduara, menaxherët e projekteve dhe mbikëqyrësit e menaxherëve nuk kanë bërë vlerësimin e performancës së kontraktuesve në modulën e menaxhimit të kontratës në platformën e-prokurimi.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxherët e kontratave nuk i kanë kushtuar rëndësinë e duhur kërkesave rregullative që projektet që përfundohen, të vlerësohet edhe performanca e kontraktorit në realizimin e kontratës publike.

Ndikimi

Mos vlerësimi i performancës së kontraktuesve nga menaxherët e kontratave, mund të ndikojë që në raste të caktuara kontraktues të papërgjegjshëm të përfitojnë kontrata publike edhe në të ardhmen.

Rekomandimi B10

Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të menaxherëve, bëjnë vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes platformës e-prokurimi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si: mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transferet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A4 - Mospërcaktimi i qartë i specifikimeve teknike dhe lëndë jokomplete

Gjetja

Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, neni 26, paragrafi 2, përcakton që për procedim të pagesës kërkohen këto dokumente: kërkesa për blerje / zotimi, kopja e kontratës që është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit si kopje autentike e origjinalit, urdhërblerja, raporti i pranimit, urdhërpagesa dhe fatura origjinale. Gjithashtu, me marrëveshjen kontraktuale duhet të përcaktohet qartë numri i punëtorëve që do të angazhohen, orarin dhe hapësirat ku do të ofrohen shërbimet e pastrimit dhe sigurimit fizik.

Nga auditimi i pagesave, janë identifikuar mangësit e mëposhtme:

- Në marrëveshjen për kryrje të shërbimeve komunale për pastrim dhe sigurim fizik të objekteve komunale, mes Komunës së Vushtrrisë dhe Ndërmarrjes Publike Lokale - Përparimi Sh.A, nuk është përcaktuar qartë orari i angazhimit dhe numri i punëtorëve që do të angazhohen në ofrimin e këtyre shërbimeve.
- Furnizimi me material shpenzues për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, në vlerë prej 3,052€, është bërë pa ndonjë kontratë publike apo procedurë të kontraktimit, por vetëm me aprovimin e zyrtarit kryesor administrativ.

Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimeve jo adekuate nga njësitë kërkuese dhe dobësive në hartimin dhe përcaktimin e qartë të kushteve specifike të marrëveshjes.

Ndikimi

Mospërcaktimi i qartë i specifikimeve teknike në marrëveshje krijon paqartësi në aspektin operativ të realizimit të shërbimeve, mbikëqyrjes, dhe në aspektin financiar. Mos aplikimi i procedurave të prokurimit dhe mungesa e analizave paraprake ndikon negativisht në konkurrencën, transparencën dhe efikasitetin e shpenzimit të fondeve publike.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë që në marrëveshjen kontraktuale të përcaktohen saktë specifikimet teknike, dhe se furnizimet e mallrave të realizohen përmes procedurave të rregullta të kontraktimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokatipale

Në PVF të e vitit 2025, Komuna e Vushtrisë ka shpalosur pasuritë neto kapitale në vlerë 125,410,666€, pasuritë jokatipale në vlerë 192,855€, dhe stoqe në vlerë 21,094€.

Çështja B11 - Pasuritë në përdorim të kategorizuara si investime në vijim

Gjetja Sipas Rregullores MF-nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në OB, neni 11, përcakton që pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria jofinanciare kapitale do të klasifikohet si pasuri jofinanciare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Në regjistrin e pasurisë kapitale, pasuritë me vlerë 13,936,945€ edhe më tutje vazhdojnë të jenë të klasifikuara si investime në vijim. Pasuritë e tilla datojnë të regjistruara nga viti 2015 deri në vitin 2023, të cilat me përfundimin e projekteve do të duhej të klasifikoheshin si pasuri aktive në përdorim. Si pasojë e kësaj, këto pasuri nuk i janë nënshtruar procesit të zhvlerësimit vjetor, me çka vlera e tyre historike nuk paraqet vlerën reale neto në fund të vitit 2025. Në pamundësi të sigurimit të informatave të sakta për kohën e funksionalizimit të këtyre pasurive, nuk ka qenë e mundur të kalkulojmë vlerën e zhvlerësimit, përkatësisht vlerën e mbivlerësimit për këto pasuri.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jofinanciare ndër vite.

Ndikimi Mbajtja e pasurive për periudha të gjata si “investime në vijim”, edhe pse ato mund të jenë në përdorim, shkakton kategorizim jo të drejtë, mungesë të zhvlerësimit dhe pamundësi për të përcaktuar vlerën reale të pasurive, duke ndikuar gjithashtu edhe në raportim financiar të pasaktë.

Rekomandimi B11 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jofinanciare, duke siguruar që të gjitha projektet kapitale të përfunduara të identifikohen dhe t'i nënshtrohen procedurave të nevojshme për transferimin në kohë në kategorinë e pasurive në përdorim, në mënyrë që të mundësohet aplikimi i drejtë i zhvlerësimit dhe raportimi i saktë financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV e vitit 2025 në total janë 9,408,820€. Vlera e të arkëtueshmeve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë (62%), taksat komunale për grumbullimin e mbeturinave (29%), taksat nga lejet ndërtimore (8%), dhe qiraja nga shfrytëzimi i pronave publike (1%).

Çështja B12 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove. Derisa, me neni 27, përcakton që nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në kontratë për secilin lloj të të hyrave.

Llogaritë e arkëtueshme nuk janë menaxhuar si duhet. Saldo e llogarive ka rritje nga viti në vit, ku në fund të vitit 2025 vlera e tyre ishte 9,408,820€, dhe në raport me vitin 2024 kemi rritje për 1,949,744€. Me gjithë veprimet e ndërmarra nga komuna në njoftimin e taksapaguesve për obligimet e papaguara, niveli i arkëtimit ende mbetet i ulët.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të duhur të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave vetanake ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B12

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	27,662,762	29,923,229	29,840,985	27,485,167	26,213,118
Grante Qeveritare - Buxheti	24,137,295	24,992,828	24,936,222	23,348,947	21,238,617
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,007,972	1,006,740	1,367,218	2,561,003
Të hyrat vetanake	3,525,467	3,895,025	3,886,481	2,754,605	2,411,650
Donacionet vendore	0	4,200	0	2,000	1,848
Donacionet e jashtme	0	23,203	11,542	12,396	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 2,260,467€. Kjo rritje është ndikuar nga vendimii i qeverisë për ngritjen e koeficientit të pagave në vlerë 855,533€, pastaj nga të hyrat e bartura të vitit paraprak në vlerë 1,007,972€, nga rritja e planit të të hyrave vetanake për 369,558€, si dhe 27,404€ nga donacionet.

Në vitin 2025 Komuna e Vushtrrisë ka shpenzuar gati tërë buxhetin përfundimtar ose 29,840,985€. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	27,662,762	29,923,229	29,840,985	27,485,167	26,213,118
Pagat dhe mëditjet	13,811,153	14,667,904	14,666,686	14,268,929	12,140,868
Mallrat dhe shërbimet	6,324,837	6,743,740	6,699,679	4,932,574	4,416,993
Komunalitë	639,625	679,183	673,632	486,810	447,458
Subvencionet dhe transferet	1,855,000	1,855,000	1,853,969	1,227,390	1,129,213
Investimet Kapitale	5,032,147	5,977,402	5,947,019	6,569,464	8,078,586

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për paga dhe mëditje është rritur për 856,751€. Rritja është ndikuar nga vendimi e qeverisë lidhur me ngritjen e koeficieontit të pagave për zyrtarët publik në vlerë 855,533€, dhe 1,218€ nga donacionet. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 99.99%.
- Buxheti për mallrave dhe shërbimeve është rritur për 418,903€. Rritja është ndikuar nga rritja e planit të të hyrave vetanake për 330,000€, nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar në vlerë 77,200€, dhe 11,702€ nga donacionet. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 99.35%.
- Buxheti final për shërbimet komunale është rritur për 39,558€, përmes rritjes së planit të të hyrave vetanake. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 99.18%.
- Buxheti për subvencione dhe transfere nuk ka ndryshuar gjatë vitit. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 99.94%.
- Buxheti për investime kapitale është rritur për 945,255€. Kryesisht rritja është ndikuar nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në vlerë 930,772€, dhe 14,483€ nga donacionet. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 95.49%. Programi i Investimeve Publike përfshin 69 projekte kapitale të vitit aktual dhe viteve paraprake. Projektet kryesisht janë dedikuar për investimet në infrastrukturën rrugore, lumenjë, ura, salla sportive, ndërtimin dhe renovimin e objekteve arsimore, kulturore dhe sportive, rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, parqe, furnizime me pajisje mjekësore, automjete, pajisje tjera, etj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2025 ishin 3,748,781€, derisa të planifikuara ishin 3,895,025€ (me ligjin e buxhetit të vitit 2025 ishin planifikuar 3,525,467€, dhe gjatë vitit me vendim të kuvendit komunal është rritur kufiri i planit fillestar për 369,558€). Të hyrat kanë të bëjnë kryesisht nga taksat për leje ndërtimore, tatimi në pronë, taksat për grumbullimin e mbeturinave, participimet nga qytetarët, si dhe taksa tjera komunale. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave ka shënuar rritje për 772,836€.

Në vitin 2025 Komuna ka përfituar 668,198€ të hyra nga gjobat në trafik, 44,790€ nga gjobat e gjykatave, dhe 907€ nga Agjencioni i Pyjeve, apo në total 713,895€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto të hyra i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për realizim të pagesave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	3,525,467	3,525,467	3,748,781	2,975,945	3,408,023
Të hyrat tatimore	1,218,427	1,218,427	933,876	665,169	1,268,599
Të hyrat jo tatimore	2,307,040	2,307,040	2,813,683	2,310,775	2,138,724
Të hyrat tjera	0	0	1,222		700

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 për Komunën e Vushtrrisë ka rezultuar me gjashtëmbëdhjetë (16) rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna, dhe se raporti i auditimit të vitit 2024 ishte diskutuar në kuvendin komunal. Gjithashtu, Komuna kishte përgatitur edhe një raport periodik për progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të vitit 2024. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, tre (3) rekomandime janë zbatuar, një (1) në proces të zbatimit, dhe dymbëdhjetë (12) rekomandime tjera nuk janë zbatuar, dhe siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë përforcimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë në PVF.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive dhe komunikim mes drejtorive ashtu që pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.	Janë ndërmarrë veprime në regjistrimin e pasurisë, ndonëse një pjesë e pasurisë deri në fund të vitit nuk kishte arritë të përfshihet në regjistrin kontabël.	Pjesërisht i zbatuar


3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në azhurnimin e regjistrit të obligimeve të papaguara në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë dhe i plotë i tyre në PVF.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për opinion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë dhe i plotë i tyre në PVF.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjet adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.	Edhe në vitin 2025 kemi keqklasifikime të shpenzimeve si pasojë e vendimeve gjyqësore.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që janë vendosur kontrole efektive për monitorimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim. Gjithashtu, për qiramarrësit të cilët nuk përmbushin kushtet e kontratës të marrë veprimet e nevojshme ligjore për mbledhjen të qirasë së pa arkëtuar nga komuna dhe të shqyrtoj mundësinë e ndërprerjes së kontratës nëse kemi të bëjmë me një shfrytëzues të pandërgjegjshëm në respektimin e kontratës.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin e Kuvendit Komunal.	Nuk janë hasur raste të shfrytëzimit të fondeve nga projektet jo përkatëse.	I zbatuar
10.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj kontrole efektive tek njësitë kërkuese dhe zyrën e prokurimit me qëllim që gjatë hartimit të specifikave teknike të mos përdoren kritere favorizuese për të siguruar që procedurat e prokurimit zhvillohen në pajtim me ligjin.	Janë ndërmarrë veprime gjatë hartimit të specifikimeve teknike.	I zbatuar

11.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që të bëhet monitorimi dhe të sigurohen raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve me qëllimin që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive. Përfituesit që nuk kanë raportuar për mjetet e shfrytëzuara të përjashtohen nga e drejta e përfitimit të subvencioneve në të ardhmen.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që vlerësimi dhe miratimi i kërkesave për subvencionim të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me rregullore dhe brenda fushëveprimit ligjor të komunës. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme dhe mbikëqyrja në procesin e vlerësimit të kërkesave për të parandaluar miratimin e ndihmave në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ose për qëllime që tejkalojnë kompetencat e komunës.	Janë ndërmarrë veprime. Në këtë vit nuk kemi pasur raste të tilla.	I zbatuar
14.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave përdorin modulën përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
15.	Pasuritë	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
16.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Drilon Osmani, Anëtar i ekipit




Endrita Gjyrevci, Anëtare e ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi


REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për
zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ferit Idrizi - ZKA



Data: 16.06.2026,
Vushtrri



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1. Rikonstruimi i Bulevardit Adem Jashari dhe ndërtimi i parkingut nëntokësor, lot 1, në vlerë 2,713,170€, siguria e ekzekutimit kishte skaduar në janar 2026, dhe nuk është vazhduar. 2. Ndërtimi i shkollës fillore Mustafë Venhari, në vlerë 1,078,258€, siguria e ekzekutimit kishte skaduar dhe e njëjta është vazhduar me 3 muaj vonesë. 3. Ndërtimi rrugës Bekim Berisha - Abeja, në vlerë 778,251.43€, siguria e ekzekutimit në vlerë 10% të vlerës së kontratës kishte skaduar në nëntor 2024, deria sigurimi i ri është bërë pas 11 muajve. 4. Ndërtimi i rrugës Lumni Surdulli - lot 2, në vlerë 685,260€, siguria e ekzekutimit në vlerë 10% të vlerës së kontratës kishte skaduar në fund të viti 2024, dhe ndonëse punët ishin duke vazhduar, siguria e ekzekutimit nuk është vazhduar. Garancionet e kulaitetit: 1. Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica dhe Lumit Llap, në vlerë 1,504,000€, nuk është ofruar garancioni i kualitetit të punimeve në vlerë 10% të kontratës dhe në afat tre vjeçar. 2. Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni, lot 2, në vlerë 153,492€, nuk është ofruar garancioni i kualitetit të punimeve në vlerë 10% të vlerës së kontratës dhe në afat 2 vjeçar. 3. Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni, lot 3, në vlerë 142,282€, nuk është ofruar garancioni i kualitetit të punimeve në vlerë 10% të vlerës së kontratës dhe në afat 2 vjeçar. 4. Ndërtimi i rrugëve Avni Saraçi dhe rrugës Vicianë në vlerë 250.019€, është kërkuar që pas përfundimit të punimeve, kontraktuesi të ofrojë garancion të kualitetit të punimeve në vlerë 10% të vlerës së kontratës dhe për afatin 5 vjeçar, derisa garancioni i ofruar ishte në afatin 2 vjeçar. 5. Furnizim me pajisje mjekësore, në vlerë 29,980€, garancioni i kualitetit të pajisjeve në vlerë 10% të vlerës së kontratës është ofruar 11 muaj pas përfundimit të kontratës, përkatësisht pas shqyrtimit të lëndës nga auditimi. 6. Furnizim me tabela te mençura, në vlerë 97,888€, garancioni i kualitetit të pajisjeve në vlerë 10% të vlerës së kontratës është ofruar nëntë (9) muaj pas përfundimit të kontratës, përkatësisht pas shqyrtimit të lëndës nga auditimi.
- ⁶ Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica dhe lumit Llap në vlerë 1,504,000€, Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni, lot 2, në vlerë 153,492€, Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni lot 3, në vlerë 142,282€, Ndërtimi i rrugëve Avni Saraçi dhe rrugës Vicianë në vlerë 250.019€, Furnizim me pajisje mjekësore në vlerë 29,980€, Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Pasomë-ritender në vlerë 72,778€, Renovimi i palestrës sportive Jeton Tërstena në vlerë 48,260€, Furnizim me tabela të mençura në vlerë 97,888€, dhe Furnizimi dhe instalimi i pajiseve për klimatizim në vlerë 31,280€.
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn • Municipality of Vushtrri

DATË/A	09.07.2026
REFERENC-Ë	08Nr. 271/2026
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES:	92 Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUMM) Drejtor i drejtorisë Drilon Jusufi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit

Të nderuar,

Bazuar në Planin e punës së Kuvendit e cila ka të bëjë me informatën lidhur me mbrojtjen e mjedisit, ju njoftojmë se bazuar në investimet kapitale për këtë vit komuna ka realizuar projektet që ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit siç janë projektet për gjelbërim, pastrimin e rrugëve, mbikëqyrja dhe përkujdesja e parqeve në pjesë të ndryshme të qytetit ku janë të përfshira edhe sektorët nga Drejtoritë përkatëse siç është Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Hap i rëndësishëm për ruajtjen e ambientit, mjedisit, infrastrukturës, krijimit të hapësirave të reja publike e të gjelbra është edhe hartimi i Planit Zhvillimor Komunal të ri për vitin 2024-2032, pasi që plani aktual është i paraparë prej vitit 2016-2024, pas miratimit të PZHK-së të fillohet me Hartën Zonale Komunale si dhe në zonat ku është e nevojshme edhe Planet Rregulluese të Hollësishme. Planifikimi urban është çelësi për të ruajtur, kujdesur dhe zhvilluar tutje mjedisin urban dhe rural sipas Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Komuna e Vushtrrisë është e vendosur që të planifikojë dhe definoj zhvillimin duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës. Komuna jonë karakterizohet nga veçoritë e saj të vlefshme natyrore si burimet ujore, kullotat, pyjet dhe trashëgimia unike historike dhe kulturore.

Reforma për menaxhim të mbeturinave është duke vazhduar grumbullimi i mbeturinave dhe transporti i tyre në deponi bëhet në vazhdimësi. Në bazë të Raportit për Vlerësimin e deponive ilegale (GIZ, AMMK dhe Komuna e Vushtrrisë). Gjendja e mjedisit është përmirësuar dukshëm, po ashtu edhe ne si drejtori e cila bën rregullimin dhe shtruarjen e rrugëve duke përfshi qytetin dhe fshatrat ku edhe hasim në deponi të ndryshme të mbeturinave ilegale të cilat menjëherë i largojmë dhe ndikimet e tilla kanë rezultate pozitive për qytetarët si dhe bëhet përmirësimi në mbrojtjen e mjedisit.

Gjendja e Mjedisit është përmirësuar dukshëm, duke filluar që nga menagjimi i mbeturinave nga kompania për menagjimin e mbeturinave Uniteti-Njësia Vushttri ka bërë shtrirje të menagjimit në pothuajse në shumicën e territorit të komunës.

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave nga Drejtoria për Shërbime Publike në bashkpunim, me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë, ka qenë i planifikuar aktiviteti për rishikimin e planit pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë 2022-2026 dhe është bërë ky aktivitet. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rreth 1600 ekonomive familjare, të cilat janë duke u paketuar në qendrën për paketim në Bukosh. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale dhe aktualisht i kemi edhe shtatë deponi të tilla. Si rezultat i këtij angazhimi ndërmarrjes „Përparimi” i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe ta përmirësojmë gjendjen e ambientit.

Gjithashtu jemi në implementim e sipër të sipërfaqeve të gjelbëruara si në qytet ashtu edhe në fshatra.

Gjithashtu përmes Ndërmarrjes komunale „Përparimi” është bërë mirëmbajtja e të gjitha hapësirave publike. Kjo praktikë e mirëmbajtjes së hapësirave publike në qytet është treguar mjaft e suksesshme pasi që janë kursyer mjete të konsiderueshme financiare të buxhetit të komunës si dhe është bërë punë më e madhe në terren.

Gjithashtu Ndërmarrjes „Përparimi” i është kaluar në menaxhim i tërë procesi i grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave.

Gjatë kësaj periudhe është bërë hartimi dhe dorëzimi në AMMK Raporti për menaxhimin e mbeturinave.

Më poshte është paraqitur gjendja me ofrimin e shërbimeve për ekonominë familjare, bizneset dhe institucionet që pranojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Në fushën e mirëmbajtjes së gjelbërimit me sukses janë realizuar projektet e planifikuara, si:

- Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ;
- Plani për pastrimin, mirëmbajtjen dhe kultivimin e parqeve të qytetit;
- Plani i ruajtjes dhe mirëmbajtjes së rrethojës, inventarit, gjelbërimit dhe drunjve në parqe;
- Plani i mirëmbajtjes së stazave dhe rrugicave në parqe;
- Është punuar edhe në planin e mirëmbajtjes së varrezave, në varreza të dëshmorëve, martirëve dhe atyre të qytetit

Kemi bërë Angazhimin për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor, si dhe zvogëlimin ose ndalimin e atyre aspekteve ekonomike dhe të aktiviteteve të tjera që përbëjnë rrezik të madh për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Bëjm mbrojtjen e biodiversitetit, duke tentuar arritjen e balancit ekologjik në territorin e komunës dhe më gjerë , mbikëqyrjen për shfrytëzimin racional dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore si dhe mbrojtjen e akumulimeve gjenetike të natyrës

Po ashtu bëjm mbikëqyrjen e pamjeve të vlefshme të natyrës, propozojm zonat e reja për mbrojtje, mbrojm dhe bëjm rehabilitimin e diversitetit dhe vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit.

Propozojmë masat për monitorimin e cilësisë, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujit, ajrit, tokës dhe natyrën e zonës së komunës të mirat natyrore publike si: hapësirat e gjelbëruara, brigjet e lumenjve.

Në kuadër të aktiviteteve për monitorimin e zonave të mbrojtura, ekipi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në bashkpunim me zyrtaret profesional nga ky organ kanë dalë në vizitë dhe janë realizuar vizita monitoruese me Monumentet e Natyrës në Komunën e Vushtrrisë.

Po ashtu në respektim të Udhëzimit Administrativ për gjërat mandatore Drejtoria e Inspektionit me shkeljen e këtyre dispozitave ligjore kjo drejtori bën shqiptimin e gjërave për ndëshkimin e qytetarëve jo të ndërgjegjshëm të cilët po huthin mbeturina vend e pa vend dhe ky ndëshkim nga Inspektorët po sjell ndikime pozitive në mjedis.

Vlenë të theksohet se edhe vendosja e linjave të kanalizimit për Ujëra të zeza ka një ndikim pozitiv ku një gjë të tillë e kemi parandaluar pothuajse gati në të gjitha fshatrat sepse me vendosjen e kanalizimit ndalohet hedhja e ujërave të zeza në ambient të hapur –lumenj ku projektet e tilla në disa fshatra janë realizuar pothuajse në tërësi dhe kanë një gjatësi me kilometra.

Bazuar në: Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Udhëzimi Administrativ Nr.01/2017 për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale i aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, obligohemi që gjatë procedurës së dhënës së Lejes Ndërtimore për objekte të cilat janë në listën për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale gjatë këtij procesi ta njoftojmë palën dhe të kërkojmë nga pala pajisjen edhe me Leje Mjedisore Komunale.

Leja Mjedisore Komunale jepet po nga ky organ pas aplikimit të palës i cili i plotëson kriteret sipas Raportit të prezantuar për ndikim të Lejes Mjedisore Komunale.

Po ashtu Komuna e Vushtrrisë ka hartuar edhe Planin e Veprimit Lokal në Mjedisit 2023-2026.

Bazuar në të cekurat më lartë Komuna e Vushtrrisë ka kontribuar vazhdimisht në përmirësimin dhe ruajtjen e Mbrojtjes së Mjedisit në tërë territorin e Komunës si dhe veprime të tillë do të ndërmerren edhe në vazhdimësi.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

Nr. / Br. 29254/26

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data: / Datum: 08.07.2026

VUSHTERI - VUČITRN



REPUBLICA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

DATE /A:	06.07.2026
REFERENCË :	05Nr. <u>110</u> /26
PËR:	Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave MPB, Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve
CC:	
PËRMES:	Z. Ferit Idrizi Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
NGA:	Z. Agim Miftari Sekretar dhe Kryesues i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera
TEMA:	Raport i Veçantë i Vlerësimit të Dëmeve nga zjarret (Periudha 2023 – Qershor 2026)

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave,

Në seancën e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, të mbajtur më datë 28.05.2026, nga anëtarët e Kuvendit është kërkuar që në kuadër të Raportit mbi Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera (i cili është dorëzuar për miratimin final në Kuvend), të përfshihen dhe të bashkëngjiten edhe rastet e dëmeve të shkaktuara nga zjarret përgjatë periudhës janar 2023 – maj 2026. Kjo kërkesë vjen si rrjedhojë e limiteve aktuale buxhetore të Komunës së Vushtrrisë, e cila e ka të pamundur t'i mbulojë këto dëme të konsiderueshme vetëm përmes fondeve vetjake lokale.

Lidhur me këtë kërkesë, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera ka përgatitur këtë dokument të veçantë përcjellës:

RAPORT I VEÇANTË MBI VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA ZJARRET PËR PERIUDHËN 2023 – QERSHOR 2026

Përmes kësaj shkrese zyrtare, Komisioni Komunal ju përcjell raportin e dëmeve të shkaktuara nga zjarret në objekte private (shtëpi banimi), shtalla, punëtori dhe shupa, të cilat janë evidentuar dhe verifikuar në teren nga ekipi ynë profesional gjatë periudhës: nga viti 2023 deri në Qershor 2026.

Si institucion komunal, ne jemi plotësisht në dijeni të përcaktimeve të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve, e cila specifikon se zjarret në objekte private nuk klasifikohen si fatkeqësi natyrore, përveç rasteve kur ato shkaktohen nga faktorë atmosferikë (rrufeja) zjarre nga temperaturat ekstreme (valet e të nxehtit), zjarret e mëdha pyjore dhe natyrore etj. Gjithashtu, duke u bazuar në praktikën administrative të vitit 2023 – ku 9 lëndë të dërguara u kthyen të refuzuara nga niveli qendror – ky raportim nuk ka për qëllim cenimin apo kontestimin e kësaj rregulloreje.

Ky rishqyrtim shërben si një **kërkesë e domosdoshme për koordinim institucional** dhe si një njoftim zyrtar mbi gjendjen e rëndë sociale dhe ekonomike të familjeve të dëmtuara. Qëllimi ynë primar është që përmes këtij komunikimi të shfrytëzohen të gjitha rrugët administrative në nivel qendror, me qëllim që Kuvendi Komunal i Vushtrrisë të ketë një pasqyrë dhe konfirmim të qartë ligjor përpara se të iniciojë ndonjë formë alternative të ndihmës apo subvencionimit emergjent lokal për këta qytetarë.

Në vijim të këtij dokumenti gjeni tabelat e detajuara të rasteve.

DËMET NGA ZJARRI NË VITIN 2023

Tabela e vlerësimit të dëmeve në ekonomi familjare të shkaktuar nga zjarri në vitin 2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendndodhja	Përshkrimi i Dëmit	Data e Ngjarjes	Shkaktari i dëmit	Vlera e Dëmit (€)
1	Arben Selimi	Novolan	Ekonomi familjare	21.03.2023	Zjarri	4,840.00 €
2	Xhevat Mehmeti	Novolan	Egonomi familjare	4.05.2023	Zjarri	17,528.00 €
3	Bujar Krasniqi	Begaj	Ekonomi familjare	20.06.2023	Zjarri	2,993.00 €
4	Fehmi Ademi	Ropicë	Egonomi familjare	10.08.2023	Zjarri	480.00 €
5	Fehmi Hyseni	Gracë	Ekonomi familjare	23.08.2023	Zjarri	6,415.00 €
6	Xhihan Lahu	Vushtri	Egonomi familjare	30.08.2023	Zjarri	11,990 €
7	Selatin Lahu	Begaj	Ekonomi familjare	20.06.2026	Zjarri	1,470.00 €
Gjithsej shuma e dëmeve						45,716.00 €

Tabela e vlerësimit të dëmeve në bujqësi të shkaktuar nga zjarri në vitin 2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendndodhja	Përshkrimi i Dëmit	Data e Ngjarjes	Shkaktari i dëmit	Vlera e Dëmit (€)
1	Fehmi Hyseni	Gracë	Bujqësi	23.08.2023	Zjarri	4,020.00 €
2	Ilmi Brahimi	Balincë	Bujqëi	25.08.2023	Zjarri	1,700.00 €
Gjithsej shuma e dëmeve						5,720.00 €

Vlera totale e dëmeve nga zjarri në vitin 2023: 45,716.00 € + 5,720.00€ = 51,436.00 € (pesëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë euro)

DËMET NGA ZJARRI NË VITIN 2024

Tabela e vlerësimit të dëmeve në ekonomi familjare të shkaktuar nga zjarri në vitin 2024

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendndodhja	Përshkrimi i Dëmit	Data e Ngjarjes	Shkaktari i dëmit	Vlera e Dëmit (€)
1	Rasim Vatovci	Novolan	Ekonomi familjare	22.06.2026	Zjarri	7,850.00 €
Gjithsej shuma e dëmeve						7,850.00 €

Vlera totale e dëmeve nga zjarri në vitin 2024: 7,850.00 €

DËMET NGA ZJARRI NË VITIN 2025

Tabela e vlerësimit të dëmeve të shkaktuar nga zjarri në ekonomi familjare për vitin 2025

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendndodhja	Përshkrimi i Dëmit	Data e Ngjarjes	Shkaktari i dëmit	Vlera e Dëmit (€)
1	Mentor Beqiri	Ceceli	Ekonomi familjare	18.03.2025	Zjarri	2,200.00 €
2	Anton Maloku	Samadrexhë	Egonomi famijare	08.06.2025	Zjarri	3,768.00 €
3	Fehmi Rama	Dubocë	Ekonomi familjare	07.07.2025	Zjarri	8,950.00 €
4	Muhamet Rama	Dubocë	Egonomi famijare	07.07.2025	Zjarri	4,208.00 €
5	Driton Maxhuni	Maxhunaj	Egonomi famijare	28.06.2025	Zjarri	5,000.00 €
6	Fadil Rama	Duboc	Ekonomi familjare	07.07.2025	Zjarri	1,000.00 €
7	Abit Rama	Duboc	Egonomi famijare	07.07.2025	Zjarri	2,536.00 €
8	Agim Hyseni	Oshlan	Ekonomi familjare	20.07.2025	Zjarri	870.00 €
9	Fehmi Gashi	Akrashticë	Shtalla	27.07.2025	Zjarri	5,328.00 €
10	Sefedin Jetullahu	Vërnice	Ekonomi familjare	24.07.2025	Zjarri	1,920.00 €
11	Drilon Murseli	Tërllabuq/Prishtinë	Egonomi famijare	10.08.2025	Zjarri	1,200.00 €
12	Elion Shahini	Novolan	Ekonomi familjare	10.08.2025	Zjarri	2,614.00 €
13	Sinan Musa	Vushtrria	Egonomi famijare	16.08.2025	Zjarri	80.00 €
14	Sadri Sinani	Zagori	Ekonomi familjare	29.09.2025	Zjarri	5,131.00 €
15	Fatlum Zejnullahu	Vushtrri	Egonomi famijare	03.10.2025	Zjarri	4,083.00 €
Gjithsej shuma e dëmeve						48,888.00€

Tabela 1-e vlerësimit të dëmeve të shkaktuar nga zjarri në bujqësi për vitin 2025

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendndodhja	Përshkrimi i Dëmit	Data e Ngjarjes	Shkaktari i dëmit	Vlera e Dëmit (€)
1	Adem Hyseni	Dumnicë e Epërme	Bujqësi	29.06.2025	Zjarri	1,610.00 €
2	Fehmi Rama	Dubocë	Bujqëi	07.07.2025	Zjarri	2,823.85 €
3	Fehmi Gashi	Akrashticë	Bujqësi	26.07.2025	Zjarri	6,440.00 €
4	Sami Salihu	Vushtrria	Bujqëi	03.08.2025	Zjarri	1,800.00 €
5	Muhamet Rama	Dubocë	Bujqësi	07.07.2025	Zjarri	14,736.80 €
6	Fadil Rama	Duboc	Bujqëi	07.07.2025	Zjarri	15,369.00 €
7	Agim Hyseni	Oshlan	Bujqësi	20.07.2025	Zjarri	6,404.84 €
8	Xhafer Salihu	Druar	Bujqëi	10.08.2025	Zjarri	54,282.24 €
9	Nasuf Strana	Shylevicë	Bujqësi	24.09.2025	Zjarri	480.00 €
Gjithsej shuma e dëmeve						103,946.73 €

Vlera totale e dëmeve nga zjarri në vitin 2025: **48,888.00 € + 103,946.73 € = 152,834.73 €** (njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e katër euro e 73 cent)

DËMET NGA ZJARRI NË VITIN 2026

Tabela e vlerësimit të dëmeve të shkaktuar nga zjarri në ekonomi për vitin 2026

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendndodhja	Përshkrimi i Dëmit	Data e Ngjarjes	Shkaktari i dëmit	Vlera e Dëmit (€)
1	Shaban Krasniqi	Sfaraqak i Poshtëm	Ekonomi familjare	15.01.2026	Zjarri	6,775.00 €
2	Hasim Mehmeti	Mihaliq	Ekonomi familjare	03.02.2026	Zjarri	4,624.70 €
3	Bashkim Bunjaku	Samaderexhë	Ekonomi familjare	31.03.2026	Shpërdhim	2,690.00 €
4	Naser Krasniqi	Ceceli	Ekonomi familjare	29.04.2026	Zjarri	7,403.00 €
5	Esat Rrahmani	Kollë	Ekonomi familjare	15.06.2026	Zjarri	1,914.00 €
Gjithsej shuma e dëmeve						23,406.70 €

Tabela e vlerësimit të dëmeve të shkaktuar nga zjarri në ekonomi për vitin 2026

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendndodhja	Përshkrimi i Dëmit	Data e Ngjarjes	Shkaktari i dëmit	Vlera e Dëmit (€)
1	Hasim Mehmeti	Mihaliq	Bujqësi	03.02.2026	Zjarri	1,847.00 €
2	Esat Rrahmani	Kollë	Bujqësi	15.06.2026	Zjarri	600.00 €
Gjithsej shuma e dëmeve						2,447.00 €

Vlera totale e dëmeve nga zjarri në vitin 2026: **23,406.70 € + 2,447.00 € = 25,853.70 €** (njëzet e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre euro e 70 cent)

Tabela përmbledhëse e vlerësimit të dëmeve nga zjarri në ekonomi dhe bujqësi sipas viteve

Nr.	Dëmet nga zjarri sipas viteve	Vlera e Dëmit (€)
1	Vlera e dëmeve nga zjarri gjatë vitit 2023	51,436.00 €
2	Vlera e dëmeve nga zjarri gjatë vitit 2024	7,850.00 €
3	Vlera e dëmeve nga zjarri gjatë vitit 2025	152,834.73 €
4	Vlera e dëmeve nga zjarri gjatë vitit 2026	25,853.70 €
	Gjithsej shuma e dëmeve gjatë vitit 203, 2024,2025 deri në maj 2026	237,974.43 €

Vlera totale e dëmeve nga zjarri gjatë viteve 2023, 2024,2025 deri në qershor 2026 është **237,974.43 €** (dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër euro e 43 cent)